

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6023
E enjte, 12 mars 2020
çmimi 0.40 €

Konjufca: Vendimi për konsujt dhe gjashtë ambasadorët ka qenë në përputhje me ligjin



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBAHET SEANCA E JASHTËZAKONSHME NË LIDHJE ME, SIÇ THUHET, RREZIKIMIN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME SHTETET E BASHKUARA

TAKSA PËRÇAN POZITËN DHE OPOZITËN



Opozita e ka akuzuar kryeministrin Albin Kurti se me veprimet e veta ka lëkundur raportet strategjike Kosovë - ShBA. Në debatin parlamentar të thirrur nga opozita të mërkurën për raportet në mes të këtyre dy shteteve,

edhe partnerja qeverisëse, LDK-ja, i ka kërkuar heqjen e menjëhershme të taksës shëfit të qeverisë. Por, këtij të fundit nuk i kanë bërë përshtypje kërkesa e LDK-së dhe as kritikrat e opozitës. Ai ka thënë se nuk bëhet fjalë për heqjen e

taksës, por për përfundim të dialogut, duke u shprehur i bindur se ka një marrëveshje Thaçi - Vuçiq. Kjo ka nxitur reagimin e presidenti Hashim Thaçi duke thënë se Kurti është një gënjeshtar dhe sabotues i shtetit të Kosovës

Rekomandohet shmangie e udhëtimeve në vendet e prekura nga koronavirusi

Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të rritjes së vigjencës ndaj koronavirusit, u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që t'i shtojnë apo t'i evitojnë udhëtimet e planifikuara brenda dhe jashtë vendit, në veçanti në shtetet ku ka raste të konfirmuara të koronavirusit, duke përfshirë shtetet fqinje: Shqipërinë,

Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka bërë me dije të mërkurën se kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për furnizim me pajisje, maska, dorëza, respiratorë, por edhe hapat e tjera që bazohen në kërkesën dhe planin e veprimt



BE-ja do të sigurojë përkrahje me ekspertë për Qeverinë e Kosovës



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

RËNDËSIA DHE JEHONA E DEMONSTRATAVE TË VITIT 1981


Ismet RASHITI



AKTUALE

KQZ-JA AKREDITON EDHE 877 VËZHgues TË RINJ PËR ZGJEDHJET NË PODUJEVË

PRESIDENTI THAÇI NDAN URDRIN "HERO I KOSOVËS" PËR 66 DËSHMORËT E BRIGADËS 125



EKONOMI

142 GJOBA PËR NDOTËSIT E MJEDISIT GJATË KATËR MUJAVE TË FUNDIT

BIZNESET DISKUTOJNË MBI NDRYSHIMET NË LEGJISLACIONIN TATIMOR

SPORT

AKUZA E NJË GRUAJE INTELEKTUALE

Shkruan:
Mehmet HAJRIZI



DASH: Në Kosovë zyrtarët e korruptuar nuk ndëshkohen

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në botë, në pjesën për Kosovën thuhet se zyrtarët nganjëherë përfshihen në praktika korruptive dhe mbesin të pandëshkuar dhe se qeveria nuk arriti ta zbatojë në mënyrë efektive ligjin që parashikon dënime penale për zyrtarët e korruptuar

WASHINGTON, 11 MARS - Departamenti Amerikan i Shtetit publikoi të mërkurën raportin për të drejtat e njeriut në botë në vitin 2019. Në pjesën për Kosovën, ky raport nxjerr si çështje kryesore: kufizimet e tepruara ndaj medieeve, përfshirë dhunën ose kërcënimet ndaj gazetarëve; korrupsioni i qeverisë dhe mosndëshkimi i tij; si dhe sulmet kundër anëtarëve të pakicave etnike ose komuniteteve të tjera të marginalizuara. "Shumë persona në qeveri, opozita, shoqëria civile dhe mediat raportuan raste të zyrtarëve të lartë të përfshirë në korrupsion që vazhdonin veprimtarinë dhe mbesin të pandëshkuar. Qeveria dhe sektori i drejtësisë ndonjëherë morën masa për t'i ndjekur penalisht dhe ndëshkuar ata zyrtarë që kryenin abuzime, vepra penale dhe krime të së kaluarës, por shumë nga ata vazhduan të ushtronin pozicione në sektorin publik", thuhet në raportin e Departamentit amerikan të Shtetit, ka njoftuar rfe.

Raporti thotë se qeveria nuk arriti ta zbatojë në mënyrë efektive ligjin që parashikon dënime penale për zyrtarët e korruptuar. "Zyrtarët nganjëherë përfshihen në praktika korruptive dhe mbesin të pandëshkuar. Mungesa e një mbikëqyrjeje efektive gjyqësore dhe sundimin e ligjit në përgjithësi i dobët, kontribuan në këtë problem", thuhet në raport.

Sa i përket sektorit të gjyqësorit, raporti thekson se "Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, por gjyqësori jo gjithmonë siguroi një proces të duhur".

DASH-i thekson se "sipas Komisionit Evropian, organizatat joqeveritare dhe institucionit të Avokatit të Popullit, administrimi i drejtësisë ishte i ngadaltë dhe nuk kishte mjete për të siguruar përgjegjësinë e zyrtarëve gjyqësorë". "Strukturat gjyqësore i nënshtroheshin ndërhyrjeve politike, me emërime të diskutueshme dhe mandate të paqarta", theksohet në raport.

Më tutje në raport thuhet se "autoritetet ndonjëherë

dështuan t'i zbatonin urdhrat e gjykatës, përfshirë edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht kur vendimet favorizuan pakicat, si në shumë raste të kthimit të pronave nga serbët e Kosovës".

Këtu merret si shembull vendimi i autoriteteve lokale të Komunës së Deçanit, të cilat refuzuan zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, që konfirmon pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe mbi më shumë se 24 hektarë tokë ngjitur me Manastirin e Deçanit. "Asnjë nga zyrtarët e përfshirë në moszbatimin e urdhrat gjyqësor nuk është sanksionuar", thekson raporti.

Sa i përket respektimit të të drejtave qytetare, raporti thekson se përderisa qeveria në përgjithësi e respektonte lirinë e shprehjes dhe të shtypit, raportet e besueshme insistuan se disa zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe fetare radikale përpiqeshin t'i frikësonin përfaqësuesit e medieeve. "Mediat, gjithashtu, hasën në vështirësi në marrjen e informacionit nga qeveria dhe institucionet publike, siç parashikohet me ligj", thuhet në raport.

Në pjesën e raportit që flet për liritë e pjesëmarrjes në procese politike, Departamenti amerikan i Shtetit, potencon se "Qeveria serbe ka vazhduar të operojë me disa struktura paralele të paligjshme qeveritare në komunat me shumicë serbe dhe në zonat e banuara kryesisht nga komuniteti kosovar-goran". "Besohet se këto struktura shpesh përdoren nga Qeveria serbe për të ndikuar në komunitetet serbe dhe përfaqësuesit politikë", thuhet në raport. "Qeveria serbe vazhdoi të operojë disa struktura paralele të paligjshme qeveritare në komunat me shumicë serbe dhe në zonat e banuara kryesisht nga komuniteti kosovar-goran", thuhet në raport.

Shembuj të kësaj përmenden pretendimet e disa pjesëtarëve të komunitetit serb për hakmarrje nga kundërshtarët politikë. "Përpara zgjedhjeve të vendit më 6 tetor, disa serbë të Kosovës raportuan se ishin nën presion për të mos mbështetur partitë e



tjera, përveç Listës Serbe, parti kjo e lidhur ngushtë me Qeverinë serbe", thekson Departamenti amerikan i Shtetit.

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, gjatë prezantimit të raportit theksoi se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara ta përdorin zërin dhe pozicionin e

saj në skenën botërore për ta tërhequr vëmendjen ndaj shkeljeve dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut dhe për të promovuar përgjegjshmëri për shkelësit dhe abuzuesit e të drejtave të njeriut. "Përvoja mëson se zyrtarët qeveritarë që shtypin, abuzojnë dhe tolerojnë

mohimin e të drejtave të njeriut janë gjithashtu përgjegjës për krijimin e mjedisve sociale që janë të pjekura si për krizat ekonomike ashtu edhe ato humanitare, dhe që inkurajojnë korrupsionin, konfliktin e dhunshëm dhe terrorizmin", tha sekretari Pompeo.



Koronavirusi në Shqipëri, 12 persona të prekur

TIRANË, 11 MARS - Ministria e Shëndetësisë ka konfirmuar se në Shqipëri janë dy raste të reja të prekura me koronavirus. Zëvendësministrja e Shëndetësisë, Mira Rakacolli, konfirmoi se numri i person-

ave të prekur ka shkuar në 12 persona, dy raste të reja gjatë 24 orëve të fundit. "Një nga personat e prekur kishte lidhje me pacientin 'zero' dhe një 78-vjeçar nga Lushnja ishte kthyer së fundmi nga Bergamo. Të dy

rastet janë në vetizolim dhe ndodhen në gjendje shumë të mirë shëndetësore. Në 24 orët e fundit janë kryer 45 testime dhe vetëm 2 kanë rezultuar pozitivë me koronavirus", tha Rakacolli.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se deri të mërkurën nuk ka të prekur nga koronavirusi në Kosovë

Rekomandohet shmangi e udhëtimeve në vendet e prekura nga koronavirusi



Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të rritjes së vigjilencës ndaj koronavirusit, u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që t'i shtyjnë apo t'i evitojnë udhëtimet e planifikuara brenda dhe jashtë vendit, në veçanti në shtetet ku ka raste të konfirmuara të koronavirusit, duke përfshirë shtetet fqinje: Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka bërë me dije të mërkurën se kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për furnizim me pajisje, maska, dorëza, respiratorë, por edhe hapat e tjera që bazohen në kërkesën dhe planin e veprimit

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 MARS - Në Shqipëri është shënuar viktima e parë nga koronavirusi. 73-vjeçarja, e cila ishte rasti i parë i prekur nga ky virus në qytetin e Durrësit, ka ndërruar jetë të mërkurën. Ministria e Shëndetësisë e Shqipërisë ka njoftuar se ka shkuar në 12 numri i personave të prekur nga koronavirusi. Ndërkaq Organizata Botërore e Shëndetësisë ka shpallur shpërthimin e koronavirusit si pandemi. Kurse në Kosovë shtatë rastet e testuara për koronavirus rezultuan negative të mërkurën. Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të rritjes së vigjilencës ndaj koronavirusit, u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që t'i shtyjnë apo t'i evitojnë udhëtimet e planifikuara brenda dhe jashtë vendit, në veçanti në shtetet ku ka raste të konfirmuara të koronavirusit, duke përfshirë shtetet fqinje (Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë) ta shmangin grumbullimin në hapësira të mbipoplluara dhe

t'u kushtojnë rëndësi masave të përgjithshme të higjienës, si parakusht themelor për parandalimin e koronavirusit. "Ministria do t'ju informojë në vazhdimësi për masat e ndërmarra kundër koronavirusit dhe u bënë thirrje mediave dhe qytetarëve, që informatat për situatën epidemiologjike rreth koronavirusit t'i marrin drejtpërdrejt nga institucionet dhe burimet zyrtare", është bërë me dije në njoftimin e MSh-së. Të mërkurën anëtarët e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kanë vizituar Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK). Në takim me drejtorin e përgjithshëm të ShSKUK-së, Basri Sejdiu, janë njoftuar në lidhje me masat që ka ndërmarrë ShSKUK-ja për mbrojtje, parandalim dhe trajtim të mundshëm të rasteve të prekura me koronavirus. Duke folur para anëtarëve të këtij komisioni, drejtori Sejdiu njoftoi se ShSKUK-ja ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për furnizim me pajisje, maska, dorëza, respiratorë, por edhe hapat e

tjera që bazohen në kërkesën dhe planin e veprimit. Ai njoftoi se QKUK-ja ka edhe 20 respiratorë rezervë dhe ka planin B të veprimit që, në rast nevojë, të rritet numri i respiratorëve për menaxhim të rasteve me koronavirus, respiratorë këta që mund të vendosen në objektin e ri të mjekësisë sportive. Pas interesimit të deputetëve, drejtori Sejdiu ka sqaruar se masat janë ndërmarrë edhe në kuadër të spitaleve të përgjithshme. Sipas tij, këto mjete mbrojtëse janë blerë përmes blerjes urgjente dhe klinikat e vijës së parë të kontaktit me pacientë, si infektivja, emergjenca, pediatria, janë furnizuar. "Kemi pasur takime edhe me drejtorët e spitaleve regionale dhe të gjitha përgatitjet që janë bërë në QKUK janë bërë edhe në spitalet rajonale. Ka përgatitje me shtretër, me infektologë. Kemi bërë kërkesë që referimet mos të bëhen pa nevojë për në QKUK", ka thënë ai.

Kryetarja e Komisionit për Shëndetësi, Albena Reshitaj, ka thënë se qëllimi i vizitës ishte

Komuna e Prishtinës ka prezantuar pesë masat parandaluese ndaj koronavirusit

Në bazë të rekomandimeve të përgjithshme të IKShP-së, Komuna e Prishtinës ka prezantuar të mërkurën masat parandaluese specifike rreth virusit COVID19:

1. Gjatë vikendit do të dezinfektohen më detajisht hapësirat e ndërtesave të Komunës së Prishtinës ku ka sportele dhe shumë punë me palë.
2. Që nga e ënjta të gjithë punëtorët e sporteleve të Komunës së Prishtinës do të pajisen me maska, dorëza dhe dezinfektues.
3. Që nga nesër shkollat dhe

çerdhet furnizohen me material higjienik shtesë sipas nevojës deri në një vendim të radhës për çerdhet dhe shkollat.

4. Komuna e Prishtinës pezullon lejet për tubimet dhe eventet publike (promovime, tubime ne sheshe) ku pritet pjesëmarrja e më shumë se 50 personave. Këtu përfshihen aktivitetet që kërkojnë leje nga Komuna për të zhvilluar aktivitetin.
5. Po ashtu njoftohen se pezullohen takimet me palë në drejtoritë e urbanizmit dhe investimeve kapitale që nuk janë me urgjencë.

njofta me masat e marra nga ShSKUK-ja për përballje me rastet e mundshme të prekura me koronavirus. Ushtruesja e detyrës së drejtoreshës në Klinikën Infektive, Lindita Berisha, ka theksuar se janë 24 orë në gjendje gatishmërie. Duke shpjeguar kapacitetin e klinikës, dr. Berisha tregoi se kanë 120 shtretër dhe 19 dhoma me oksigjen qendror, 6 shtretër në mjekim intensiv. Deputetët u interesuan në lidhje me furnizimin me oksigjen, gjendjen e higjienës, shtimin e stafit të infermierëve dhe pyetje tjera, për të cilat drejtori i ShSKUK-së u shpjegoi se janë ndërmarrë masat e duhura.

Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" i ka bërë thirrje qeverisë të marrë masa urgjente për t'u mbrojtur nga koronavirusi. "Unë i bëj thirrje qeverisë të marrë masa urgjente për ta siguruar gatishmërinë e sistemit tonë për t'u përgjigjur sfidës që na vjen. Shkollat duhet të mbyllën për disa ditë në mënyrë që fëmijët të mbrohen dhe ngjarjet ku ka masa të anulohen. Kosova, gjithashtu, duhet të sigurojë rezerva të ushqimit dhe materialeve të kujdesit shëndetësor në mënyrë që të mund t'u përgjigjet pa presion kërkesave", ka thënë ish-ministri i Punëve të Jashtme.

MBAHET SEANCA E JASHTËZAKONSHME NË LIDHJE ME, SIÇ THUHET, RREZIKIMIN E MARRËDHËNIEVE DI

TAKSA PËRÇAN POZI

Opozita ka akuzuar kryeministrin Albin Kurti se me veprimet e tij ka lëkundur raportet strategjike Kosovë - ShBA. Në debatin parlamentar të thirrur nga opozita të mërkurën për raportet në mes këtyre dy shteteve, edhe partnerja qeverisëse, LDK-ja, i ka kërkuar heqjen e menjëhershme të taksës shefit të qeverisë. Por, këtij të fundit nuk i kanë bërë përshtypje kërkesa e LDK-së dhe as kritikën e opozitës. Ai ka thënë se nuk bëhet fjalë për heqjen e taksës, por për përfundim të dialogut, duke u shprehur i bindur se ka një marrëveshje Thaçi - Vuçiq. Kjo ka nxitur reagimin e presidenti Hashim Thaçi, duke thënë se Kurti është një gënjeshtar dhe sabotues i shtetit të Kosovës



EPOKA E ENJTE
Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 MARS - Subjektet politike opozitare dhe partnerja qeverisëse, LDK-ja, i kanë bërë thirrje kryeministrit Albin Kurti që të bëjë kujdes me raportet Kosovë - ShBA. Në debatin parlamentar për raportet Kosovë - ShBA, të kërkuar nga opozita, PDK-ja, AAK-ja, Nisma, AKR-ja kanë vlerësuar se me veprimet e qeverisë kanë dëmtuar raportet strategjike në mes të dy vendeve. Ndërsa LDK-ja ka kërkuar nga kryeministri heqjen e menjëhershme të taksës ndaj mallrave serbe ashtu siç po kërkon ShBA-ja, pa kushte. Kritikën e opozitës dhe kërkesat e LDK-së nuk i kanë bërë përshtypje kryeministrit Kurtit. Ai ka bërë të qartë edhe një herë se nuk do ta heqë taksën ashtu siç po kërkon ShBA-ja. Ai e ka kritikuar partnerin qeverisëse, se ka ndryshuar qëndrim ndaj taksës, duke e ftuar atë të thërrasë referendum për këtë çështje.

Selimi: Opozita është e ndarë për taksën dhe bashkë kundër qeverisë Kurti

Shef i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se kërkesat e opozitës janë të pakuptueshme dhe të paqëndrueshme. Ai para deputetëve ka prezantuar edhe një draft-rezolutë, me tri pika, duke kërkuar që e njëjta të votohet nga Kuvendi. Ai ka thënë se Kosova dhe ShBA-ja nuk i prishin raportet për taksën 100 për qind. "Ne shprehim mirënjohje për ShBA-në", ka thënë Selimi, duke theksuar se opozita është e ndarë për taksën

dhe e bashkuar kundër qeverisë Kurti. Më tutje, Selimi ka thënë se kryeministri Kurti është shprehur qartë në lidhje në lidhje me taksën, zëvendësimin e saj me reciprocitetin.

Gashi: Kryeministër, hiqe sa më shpejt taksën

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, në fjalën e tij në seancë ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që ta heqë taksën ndaj Serbisë pa kushte. "Taksa duhet të hiqet dhe për këtë ka pajtim pothuajse në mes të një shumice dërrmuese të deputetëve, pra përfaqësuesve të popullit. Edhe AAK-ja, që është kundër heqjes së tarifës në

parim, besoj se do të bashkëngjitet në procesin e unifikimit të qëndrimit kosovar përballë atij serb, në negociatat e udhëhequra nga ShBA-ja.

AShAK-u: Klasa politike është duke e çuar shtetin e Kosovës drejt zhbërjes

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK) ka theksuar se me shqetësim është duke i ndjekur zhvillimet më të fundit politike në Kosovë, të nxitura nga një betejë e ashpër dhe e paparimtare midis subjekteve politike dhe institucioneve kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kjo akademi ka thënë se shteti i Kosovës është duke rrezikuar të shkojë drejt zhbërjes për "interesa meskine" të klasës politike. "Ne nuk mund të pranojmë që për interesa të Serbisë, të mbijetesës së një klase politike nacionaliste në zgjedhjet që do të mbahen atje, Kosova të përfshihet në krizë dhe të bëjë koncesione deri në humbje të subjektivitetit shtetëror, të rregullimit të

brendshëm kushtetues, apo të tërësisë territoriale dhe integritetit, sikundër që nuk mund të pranojmë që një klasë politike, e përfshirë në betejë të paparimtare për pushtet, ta vendosë Kosovën në një 'zjarr të kryqëzuar' hipotetik ndërmjet miqve tradicionalë dhe njësoj të rëndësishëm, ShBA-së dhe BE-së, duke shpallur së fundi Brukselin 'armik të Kosovës', po atë Bruksel ku kemi ngarendur deri së fundi për të arritur marrëveshje përfundimtare me Serbinë, për të bërë marrëveshje poshtëruese për Kosovën dhe ku synojmë një ditë të përfshihemi në integritet euro-atlantike", është thënë në reagimin e AShAK-ut.

Kemi folur për këtë taksë gjerë e gjatë, për dhe kundër, me argumente e shifra, kush sa kemi mundur, por neve na kërkohet të veprojmë, jo të analizojmë e prolongojmë procesin. Prandaj, kërkoj nga kryeministri Kurti, duke i ofruar gjithë mbështetjen e LDK-së, të heqë sa më shpejt plotësisht taksën", ka thënë Gashi, duke shtuar se asnjë nga aleatët tanë perëndimorë amerikanë apo evropianë nuk kanë miratuar këto masa. Në këtë drejtim, Gashi ka kërkuar unitet të përgjithshëm në vend.

Kurti: Ka një marrëveshje të fshehtë Thaçi - Vuçiq

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në fjalën e tij në Kuvend ka thënë se ai është i bindur që ka një qëndrim normal e, sipas tij, ky është zëvendësimi i taksës 100 për qind me reciprocitetin. "Dhe ka një qëndrim sublim normal, e ky është zëvendësimi gradual i taksës 100 për qind me reciprocitetin. Përgjatë këtij zëvendësimi gradual do të krijoheshin edhe masat e mirëbesimit për dialogun e ardhshëm", ka thënë ai. Kurti i ka dhënë përgjigje edhe

LDK-së sa i përket kërkesë së saj për heqje të taksës. "Ne në fushatë kemi garuar me reciprocitetin. Të gjithë ne që në fushatë kemi garuar me reciprocitetin dhe kemi marrë votat e qytetarëve është e domosdoshme që për ndryshim të qëndrimit të kthehemi te qytetarët dhe minimumi i korrektësisë demokratike e thotë që ata që kanë ndryshuar qëndrim duhet të kërkojnë referendum", është shprehur ai. Kurti ka shtuar se këtu nuk bëhet fjalë për heqje të taksës e fillim të dialogut, duke shtuar se ka marrëveshje në mes të Thaçit dhe Vuçiqit. "Kjo është gënjeshtar. Bëhet fjalë për heqje të tarifës e për mbyllje të dialogut me një marrëveshje të gatshme. Midis dy presidentëve, unë jam i bindur se ka marrëveshje të gatshme. Dhe ajo që po kërkohet është të thyhet Qeveria e Kosovës, të thyhem unë si kryeministër, në mënyrë që të marrë fuqi ai që në emër të Kosovës në negociata sekrete ka bërë marrëveshje që tash të gatshme do ta servoj jo për të filluar dialogu, por për të mbyllur çfarëdo mundësie për dialog", ka deklaruar kryeministri.

PLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME SHTETET E BASHKUARA

TËN DHE OPOZITËN



Kurti ka thënë se është gabim pozicioni ekstremist. "As heqje tarife pa reciprocitet dhe as insistim në tarifë duke mos u angazhuar për reciprocitet", ka thënë ai.

Veseli: Qeveria Kurti po bëhet kundërshtarja më e madhe e Kosovës dhe ShBA-së

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se nuk ka besuar kurrë se do të vijë një ditë që të flasë në Kuvendin e Kosovës për rëndësinë e raporteve Kosovë - ShBA. Lideri i opozitës, Kadri Veseli, ka thënë se për vetëm një muaj qeverisje Albin Kurti nuk ka ndërmarrë asgjë në politikën e brendshme, në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve, ndërsa për pak ditë qeverisje po e rrezikon edhe shembjen e investimit historik në marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Nuk e kam besuar se do të vinte një ditë si kjo, që në Kuvendin e Republikës së Kosovës do të flisnim në këtë mënyrë për rëndësinë e raporteve tona me Shtetet e

Bashkuara të Amerikës. Nuk e kam besuar as që për vetëm pak ditë kjo qeveri do të krijonte kaq shumë paqartësi, kaq shumë frikë qytetare dhe dilema shtetërore. Jo, se kam pasur ndonjë iluzion në këtë koalicion

qeverisë. Por, kam besuar se nuk do të harrohet asnjëherë rruga dhe çmimi që na kanë sjellë deri këtu", ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se sjelljet e kryeministrit aktual po e rrezikojnë miqësinë e shenjtë

ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së. "Dhe, më e rënda, mbase edhe për shkak të dogmave ideologjike personale, po sakrifkohet qytetari dhe shteti, në vend se të sakrifikohej dogma, për ta ruajtur qytetarin dhe shtetin. Pas një muaji shqetësimesh, të ditëpërditshme, kulmi po arrihet me paralajmërimet e fundit për Kosovën nga partnerja jonë më e madhe strategjike, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për tërheqjen e trupave ushtarake dhe suspendimin e programeve zhvillimore në vlerë prej qindra milionë dollarësh", ka thënë Veseli.

Limaj: Kosova ka një qeveri që flet me shumë zëra

Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se roli i qeverisë dhe një prej detyrave kryesore është thellimi i miqësisë dhe kultivimi i aleancave. Ai ka thënë se koalicioni LV-LDK nuk janë është sa iu përket vendimeve që duhet të merren. "Kosova ka një qeveri që flet me shumë zëra dhe nuk ka një zë. Sot Kosova ka një shumicë që për çështje të rëndësishme flet me qëndrime të ndryshme", ka thënë Limaj. Sipas tij, qeveria s'është e gatshme të marrë vendime. Ndër të tjera, Limaj ka kritikuar krahasimin e paralajmërimeve për largim të trupave amerikane nga Kosova me largimin e trupave që po bëhet nga Afganistani. Limaj ka

thënë se krahasime të tilla janë skandaloze pasi, siç ka thënë ai, populli i Afganistanit çdo ditë kërkon që amerikanët të largohen nga atje, ndërsa populli i Kosovës ka bërë kërkesë që ata të vijnë në Kosovë. "Zyrtarët tanë krahasojnë largimin e trupave nga Kosova me Afganistanin. Paramendojeni. Ne e relativizojmë largimin e trupave me Afganistanin. Harrojnë që populli i Afganistanit kërkon që amerikanët të largohen. Harrojnë që ne i kemi ftuar amerikanët me dekada. Pretendimet tona janë për të shkuar në NATO", ka potencuar Limaj.

Ai ka kritikuar edhe idenë e Ministrisë të Integritetit, Blerim Reka, për idenë e kompromisit, duke i dhënë Serbisë korridor për dalje në Adriatik. "Më pëlqej një zyrtar i qeverisë që kjo situatë është vetëm 'bishti i dardhës'. E vërtetë është që veç 'bishtin e dardhës' jeni tu e pa. Kuku çka ka për t'ju gjetur. Edhe dardhën keni për ta përpirë", ka deklaruar Limaj.

Selmanaj: Kosova po rrezikon partneritetin me ShBA-në

Deputet i AAK-së, Rasim Selmanaj, i cili ka folur në emrin e grupit parlamentar, ka thënë se qeveria në krye me Albin Kurtin nuk kanë plan qeverisë. "Kosova e ka qeverinë e re Kurti që erdhi me premtimet për një koalicion të shpresës. Doli se nuk e ka planin qeverisë, madje as pas takimit në Prevallë. Ky koalicion thoshte se ka strategji të qartë për dialogun. Kjo nuk ekziston. Qeveria me qëndrime të ndryshme të jep përshypje se i ka humbur rruga në mes të oborrit", ka thënë ai.

Selmanaj ka shtuar se kjo qeveri është duke e rrezikuar partneritetin me ShBA-në. "Ju e keni futur veten në një udhëkryq, për më keq Kosova po rrezikon partneritetin me ShBA-në, është një situatë e prekshme dhe deri-diku shqetësuese. Partnerët e koalicionit nuk kanë qëndrime të njëjta për taksën, as për dialogun e as për reciprocitetin e shumë të përfolur të Albin Kurtit. Kur njeri e fut veten në një udhëkryq pa shtegdalje, normalisht se do të ndodhin gabime. Mendoj se keni gabuar dhe jeni treguar i pamatur. Siç duket, do të mbeteni pa argumentin më të rëndësishëm", ka thënë Selmanaj.

Thaçi: E vetmja konstante e Kurtit është të qenit në anën e kundërt të Amerikës

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguar ndaj deklaratës së kryeministrit Albin Kurti, i cili, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit për raportet Kosovë - ShBA, ka thënë se presidenti Thaçi ka marrëveshje me atë të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook" e ka quajtur Kurtin të frustruar, frikacak dhe djallëzor. "I frustruar, vazhdon gënjeshttrat dhe mashtrimet. Frikacak dhe djallëzor, po përçan politikën dhe institucionet e Kosovës.

Përlesh dhe saboton shtetin. Nuk ka guxim as ta heqë taksën, as ta vërë reciprocitetin. I padinjitet. Po angazhohet për shkatërrimin e aleancave historike. Me paranojë flet për marrëveshje sekrete Kosovë - Serbi. Qesharake për Kosovën. Fyese dhe e rrezikshme për raportin e Kosovës me ShBA-në", ka shkruar Thaçi. Më tej, presidenti ka shkruar se këtë qëndrim kundër, Kurti e ka mbjellë në kohën e Konferencës së Rambujesë. "Ishte kundër administratës Klinton. Edhe në Vjenë,

kundër administratës Bush. Edhe me demarkacionin me Malin e Zi kundër administratës Obama-Biden. Edhe tash kur ofrohet një mundësi nga administrata e presidentit Trump për njohje reciproke, Kurti përsëri kundër. E vetmja konstante e Kurtit është të qenit në anën e kundërt të Amerikës. Në anën e kundërt të historisë. Populli i Kosovës ka besim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aleanca me ShBA-në është e shenjtë. Ne të gjithë e kemi për detyrë ta mbrojmë", ka shkruar Thaçi.

Presidenti Thaçi ndan urdhrin 'Hero i Kosovës' për 66 dëshmorët e Brigadës 125

PRIZREN, 11 MARS (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën ka ndarë dekorata për 66 dëshmorët e Brigadës 125 të Zonës Operative të Pashtrikut. Presidenti Thaçi ka thënë se është në Prizren sot për t'i nderuar dëshmorët e rënë në luftë për liri, për çlirim, pavarësi dhe bashkim kombëtar në Zonën Operative të Pashtrikut. "Sakrificat e të rënëve për liri, invalidëve të luftës, veteranëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve, sot është institucionalizuar, sot është vlerë shtetërore që e mban shtetin të fortë, unik, të qëndrueshëm dhe të sigurt edhe për të ardhmen", u shpreh

presidenti Thaçi. Edhe pse me mjete modeste, kreu i shtetit theksoi se të gjitha ato vajza dhe djem të Kosovës luftuan me shpirt dhe vendosmëri të madhe dhe e arritën atë të cilën vetëm e kishim ëndërruar. "Besonim në drejtësi, në luftën tonë, në sakrificën tonë dhe në vlerat perëndimore, prandaj edhe fituam. Dhe këtë fitore duhet ta kujtojmë gjithmonë. Këtë sakrificë duhet ta respektojmë gjithmonë", shtoi ai. Në përputhje me kompetencat kushtetuese, presidenti Thaçi i ka dekoruar 66 dëshmorët e Brigadës 125 me urdhrin "Hero i Kosovës".



Ministri Quni dhe ambasadorja franceze pajtohen për bashkëpunim në fushën e sigurisë

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 MARS - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, në vazhdim të vizitave të ambasadorëve të vendeve mike, ka pritur të mërkurën në Ministrinë e Mbrojtjes, ambasadorën e Francës në Kosovë, Marie Christine Butel. Quni ka falënderuar ambasadorën Butel për vizitën e saj dhe ka shprehur falënderimin për Republikën e Francës, si vend mik, në mbështetjen e ofruar vendit tonë deri më tani në të gjitha fushat, duke theksuar rolin e saj në sigurinë e përgjithshme, në vitet e rindërtimit dhe zhvillimit të vendit me kontingjentin ushtarak të KFOR-it. Ministri Quni ka theksuar rëndësinë e madhe që ka finalizimi i procesit të nisur për nënshkrimin e marrëveshjes së



bashkëpunimit bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes të Francës, duke pasur parasysh përvojën e madhe të forcave ushtarake franceze në përgjithësi dhe në realizimin e suksesshëm të operacioneve

paqeruajtëse në veçanti, me kërkesën edhe për këshillëdhënie profesionale ushtarake. "Pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse është ndër detyrat kryesore ligjore të FSK-së, andaj edhe synimi ynë

është zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve operacionale kompatible dhe të ndërveprueshme me forcat e vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s. Ky synim do të kurorëzohet me ofrimin e mundësisë për ofrimin e kontributit tonë në kuadër të forcave shumëkombëshe për paqen, stabilitetin dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë", ka thënë ai. Ndërsa ambasadorja Butel ka uruar ministrin Quni për marrjen e detyrës së re duke njoftuar për interesimin e Francës për zhvillimet në FSK dhe procesin e tranzicionit të saj. Ajo ka shprehur gatishmërinë e shtetit francez që përmes Ministrisë së saj të Mbrojtjes dhe atasheve ushtarakë respektivë, ndërmjet dy vendeve t'i thellojnë kontaktet me diskutimin përmbajtësor të temave me interes të përbashkët

deri në nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit bilateral. Ambasadorja Butel, ndër të tjera, shprehu edhe interesimin për projektin e shërbimit të obligueshëm ushtarak, për të cilin ministri Quni e informoi nga këndvështrimi profesional duke theksuar rëndësinë e këtij projekti; nga dimensionet edukativ, arsimor, social, ndërkombëtare, integruar dhe kultivimin e vlerave të mëdha që ka diversiteti kulturor, etnik dhe fetar i vendit për gjeneratat e reja. Butel premtoi se Republika e Francës do ta vazhdojë bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në dhe bashkë me ministrin Quni u pajtuan që të arrihet marrëveshja e bashkëpunimit bilateral me interes në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së përgjithshme.

KQZ-ja akrediton edhe 877 vëzhgues të rinj për zgjedhjet në Podujevë

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është në fazën finale të përgatitjeve për zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës. Në mbledhjen e së mërkurës, KQZ-ja ka akredituar edhe 877 vëzhgues të tjerë, të cilët u takojnë subjekteve politike garuese, mediave si dhe organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare. Sipas shifrave të KQZ-së, deri më tani numri i përgjithshëm i vëzhguesve të akredituar është 1 487 vëzhgues. Subjektet politike dhe OJQ-të kanë pasur afat të aplikojnë deri më 10 mars, ndërsa afati për

aplikim të mediave përfundon të enjten. Sipas KQZ-së, vetëm vëzhguesit e akredituar mund ta përcjellin procesin zgjedhor në vendvotime në ditën e zgjedhjeve dhe procedurat e tjera në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Në garë për kryetar të Komunës së Podujevës janë vetëm tre kandidatë: Nexhmi Rudari (LDK), Shpejtim Bulliqi (LV) dhe Naim Fetahu (PDK). Podujeva ka shkuar në zgjedhje të jashtëzakonshme për shkak se Agim Veliu ka dhënë dorëheqje nga posti i kryetarit të komunës për ta marrë detyrën e ministrit të Punëve të Brendshme në qeverinë Kurti.



Konjufca: Vendimi për konsujt dhe gjashtë ambasadorët ka qenë në përputhje me ligjin

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 MARS - Ministri i Jashtëm dhe i Diasporës, Glauk Konjufca, ka raportuar të mërkurën para anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme, i cili e ka ftuar për shkak të vendimit për shkarkimin e konsujve dhe të propozimit për shkarkim të ambasadorëve në disa shtete. Konjufca ka thënë se këto vendime i ka marrë në përputhje me ligjin dhe se emërimi i deritanishëm i shërbyesve të huaj është shqetësues dhe sfidë për udhëheqjen e re të MPJD-së. "Të gjitha ato emërimet kanë qenë jashtë procedurave ligjore dhe pa konkurs. Vendimi për konsujt dhe gjashtë ambasadorët ka qenë në përputhje me ligjin, i cili thotë se nuk parashihet një mandat i dytë i të zgjedhurve politikë dhe



se shërbejnë vetëm për një mandat dhe pas përfundimit nuk konsiderohen shërbyes të jashtëm. Arsyeja pse i kam marrë këto dy vendime është për të vendosur një ligjshmëri

brenda ministrisë dhe ky angazhimi imi nuk përfundon vetëm me këto dhe nuk përfundon këtu. Kam filluar nga shkëlqet me brutale, s'kemi kaluar ende në një fazë të shqyrtimit se si

diplomatët e kryejnë punën e tyre dhe në përputhje me një performancë ta vlerësojmë. Dy vendimet e para kanë pasur të bëjnë vetëm me ligjshmërinë", ka thënë ministri Konjufca.

Ai ka treguar se kur ka kërkuar nga MPJ që ta sjellin një gjendje të emërimeve politike dhe profesionale të shefave të misioneve, rezultati ka qenë shqetësues. "Tash ndodhim në një gjendje ku 70 janë të emëruar politikë, 30 janë të karrierës apo shërbimit brenda MPJ-së. Kjo është problematike dhe situata është jashtë ligjit. Ajo çka kërkohet prej ministrisë është ta kthejmë në kontroll gjendjen. Këto vendime i kontribuojnë këtij qëllimi. Nga ky aspekt ka qenë edhe ndërhyrja jonë", ka thënë ministri Konjufca. Mes tjerash ai ka folur edhe për pengesën e presidentit në kthimin e ambasadorëve. Sipas tij, nëse presidenti nuk e nënshkruan shkarkimin e ambasadorëve, kërkesën do ta dërgojë në kushtetuese. "Nëse presidenti mendon ta ndërpres, jam për betejë kushtetuese me të", është shprehur Konjufca.

BE-ja do të sigurojë përkrahje me ekspertë për Qeverinë e Kosovës

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Pas vendimit të marrë nga qeveria e re për zvogëlimin e numrit të ministrive dhe kërkesës së kryeministrit Kurti drejt BE-së për sigurimin e asistencës me ekspertë, për t'i diskutuar modalitetet e një mbështetje të tillë u zhvillua një takim i parë i kryesuar nga zëvendëskryeministri Avdullah Hoti dhe Haki Abazi dhe udhëheqësja e Zyrës së BE-së/PPBE-së, ambasadorja Nataliya Apostolova, përfaqësuesit e SIGMA-s dhe ministrinë përkatëse të linjës për të diskutuar çështjet që lidhen me një riorganizim të tillë dhe implikimet që kanë të bëjnë me Ligjin e ri për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. "Pronësia e plotë nga



qeveria është vendimtare për ta kthyer në sukses bashkimin dhe ristrukturimin e ministrive. BE-ja

është e gatshme ta mbështesë një proces të tillë të udhëhequr nga qeveria, si dhe t'i ndajë me

Qeverinë e Kosovës përvojat e veta të përpjekjeve të ngjashme për reforma nga vendet anëtare të BE-së dhe rajoni. Kështu, u ndërmor një hap për fillimin e një dialogu me ministrat e përfshirë, sekretarët e përgjithshëm dhe personelin tjetër përgjegjës për procesin e ristrukturimit, në mënyrë që ta kuptojnë gjendjen aktuale, objektivat specifike, nismat në vazhdim, si dhe pritshmëritë ndaj një mbështetjeje të tillë. Gjatë ditëve të ardhshme do të zhvillohen diskutime të mëtuqshme dhe më të hollësishme me ministrat dhe ministrinë e interesuara", është thënë në njoftimin e Zyrës së BE-së në Kosovë. SIGMA (Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim) është një iniciativë e përbashkët e OECD-së

(Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) dhe BE-së. Objektivi i saj kyç është forcimi i themeleve për qeverisje të përmirësuar publike përmes ndërtimit të kapaciteteve të sektorit publik, përmirësimit të qeverisjes horizontale dhe përmirësimit të dizajnit dhe zbatimit të reformave të administratës publike, duke përfshirë prioritetizimin, renditjen dhe buxhetimin e duhur. Nga ana tjetër, të martën ka startuar projekti specifik i Asistencës Teknike të BE-së në mbështetje të zbatimit të tre ligjeve të RAP-së që u miratuan në shkurt të vitit të kaluar. Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura siguron kornizën kyçe për punën në vazhdim.

Ministrja Bajrami: Arsimit, prioritet i qeverisë

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, së bashku me ambasadorin britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka marrë pjesë në ceremoninë e shpalljes së fituesve të garës së tretë me radhë "Sfida e kodimit" për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta, të organizuar nga British Council në kuadër të projektit "Shkollat e shekullit 21". Me

këtë rast, ministrja Bajrami falënderoi British Council dhe përgëzoi mësime të mëdha dhe nxënësit për punën dhe angazhimin rreth kësaj gare. Ministrja, ndër të tjera, theksoi se arsimit tashmë është prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe çdo aktivitet që ka për qëllim ngritjen e cilësisë në arsim, shkencë, teknologji dhe inovacion do të inkurajohet dhe mbështetet. Ajo tha se MASHTI e konsideron pro-

gramin e shkollave të shekullit 21, një nga iniciativat më të rëndësishme në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët me qëllim të avancimit të dijes së nxënëseve.

Ministrja Bajrami përmendi edhe faktin se vitin e kaluar në një garë të tillë rajonale Kosova është renditur në vendin e dytë, ndërsa uroi që këtë vit vendi ynë ta marrë vendin e parë. Në fund të këtij organizimi u ndanë edhe çmime për



tri projektet më të mira pjesëmarrëse në këtë garë, e cila synon t'i frymëzojë të rinjtë të zgjidhin probleme të jetës së

përditshme me të cilat përballen shkollat dhe komunitetet përmes programimit të pajisjeve.

142 gjoba për ndotësit e mjedisit gjatë katër muajve të fundit



PRISHTINË, 11 MARS (ER) - "Let's Do It" ka vazhduar monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore nga inspektorët komunalë mjedisorë dhe qendrorë për shqiptimin e gjobave për ndotësit. Bazuar në të dhënat e monitorimit, rezultojnë se gjatë këtyre katër muajve janë shqiptuar gjithsej 142 gjoba mandatore sipas këtij udhëzimi dhe rregulloreve komunale. Sipas monitorimit të bërë për muajt nëntor, dhjetor, janar

dhe shkurt, rezultojnë se Peja i prin listës së komunave me më së shumti gjoba të shqiptuara, gjithsej 27, pasuar nga Prishtina me 17 gjoba të shqiptuara, derisa nga 13 gjoba kanë shqiptuar inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komuna e Skenderajt, ndërsa Komuna e Istogut dhe Ferizajt kanë shqiptuar nga 12 gjoba. Me dhjetë gjoba të shqiptuara lista vazhdon me Komunën e Vushtrrisë, pasuar nga komuna e Vitisë dhe e Suharekës me

gjithsej nga pesë gjoba. Ndërsa gjatë këtyre muajve në Komunën e Lipjanit, Malishevës dhe Shtimes janë shqiptuar nga katër gjoba, në komunën e Gjilanit, Hani të Elezit, Kamenicës dhe Rahovecit janë shqiptuar nga tri gjoba, në Komunën e Obiliqit dy gjoba, e nga një gjobë Komuna e Mitrovicës dhe Komuna e Deçanit. Në muajt nëntor, dhjetor, janar dhe shkurt asnjë gjobë nuk është shqiptuar në komunat, si: Prizren, Podujevë, Kaçanik,

Gjakovë, Junik dhe Drenas. Nga të dhënat e monitorimit rezultojnë se llojet më të shpeshta të gjobave të shqiptuara gjatë muajve: nëntor, dhjetor, janar dhe shkurt ishin ai i ndotjes së mjedisit përreth hapësirave të objekteve publike, dëmtimi i hapësirave të gjelbëruara dhe hedhja e mbeturinave nga vetura.

Udhëzimi Administrativ për Ndëshkime me Gjoba Mandatore është në fuqi që nga viti 2009 dhe në fushatën "Ta

Pastrojmë Kosovën", 15 shtator - 15 dhjetor 2018, ka ndodhur plotësim-ndryshimi i tij. Ky udhëzim ka synim reduktimin dhe eliminimin e ndotjes së mjedisit dhe shëndetin e njeriut, mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe private përmes menaxhimit të mbeturinave. "Let's Do It" ka njoftuar se monitorimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore do të vazhdojë edhe në muajt në vijim, kur edhe do të bëhen publike të gjitha të dhënat.

Bizneset diskutojnë mbi ndryshimet në legjislacionin tatimor

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Deloitte Kosova organizuan punëtorinë mbi ndryshimet e ligjeve për Tatim në të Ardhura të Korporatave dhe të Aplikimit të Ngarkesës së Kundërt në Ndërtimtari, ku përfaqësues të bizneseve u informuan mbi ndryshimet e legjislacionit tatimor të cilat kanë ndodhur gjatë vitit të fundit.

Afrote Rudi, drejtoreshë e Departamentit të Tatimeve dhe Shërbimeve Ligjore në Deloitte Kosova, ka thënë se ndryshimet e fundit përmbledhin një përmbushje të plotë të ndryshimeve të legjislacionit tatimor të cilat kanë filluar qysh para dhjetë vjetësh. Ajo ka shtuar se me ndryshimet e fundit është bërë një përafrim mjaft i konsiderueshëm i legjislacionit të Kosovës me atë evropian dhe ndërkombëtar. Ndër të tjera,

Rudi ka potencuar faktin se Administrata Tatimore e Kosovës ka avancuar jashtëzakonisht në zbatimin e legjislacionit tatimor, duke përfshirë edhe respektimin e direktivës së BE-së në lidhje me aplikimin e ligjit për TVSh si dhe zbatimin e marrëveshjeve të dyfishta për eliminimin e tatimeve.

Arian Zeka, drejtor Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, ka thënë se gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit ka pasur një sërë ndryshimesh në legjislacionin tatimor, gjersa Oda Amerikane përmes komitetit tatimor ka qenë një ndër kontribuueset më të mëdha në këto ndryshime.

Zeka ka shtuar se fokus i Odës Amerikane mbetet kujdesi për mosrritje të normave tatimore, veçanërisht të Ligji i Tatimit në të Ardhura Personale. Më tutje, ai ka theksuar nevojën e të pasurit më shumë marrëveshje për



eliminimin e tatimit të dyfishtë, të cilat janë shumë të nevojshme për tërheqjen e investitorëve të huaj.

Ruzhdi Zenelaj, menaxher i Lartë për Tatime dhe Ardian Rexha,

menaxher i Shërbimeve Ligjore në Deloitte Kosova, i informuan të pranishmit rreth ndryshimeve dhe risive në këto ligje, përkatësisht në Ligjin për Sponsorizimet, Provizionet për

Bankat dhe Kompanitë e Sigurimeve, ndryshimet e Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe aplikimin e ngarkesës së kundërt në lëmin e ndërtimit.

Abdixhiku e njofton shefin e Zyrës Diplomatike Belge për projektet infrastrukturore

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, të mërkurën ka pritur në takim shefin e Zyrës Diplomatike të Belgjikës në Kosovë, Jean-Louis Servais. Në

këtë takim njoftues, ministri Abdixhiku e informoi përfaqësuesin belg me prioritetet qeveritare në infrastrukturë dhe mjedis. Ai tregoi për vendosmërinë e përfundimit të

projekteve infrastrukturore që kanë zgjatur për shumë vite dhe sjelljen e risive në aspektin e ruajtjes së mjedisit. Më tutje, tregoi për vendosmërinë që secili proces në dikasterin që ka marrë

në drejtim, ta bëjë me transparencë të plotë. Servais, i dëshiroi ministrit sukses në punë, ndërsa tha se dëshiron intensifikim të bashkëpunimit mes të dyja vendeve.



Zeka: Të hiqet taksa pa asnjë kusht

Kryetari i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, i ka quajtur serioze thirrjet nga senati amerikan për heqjen e trupave amerikane nga Kosova. Ai ka thënë se është momenti i fundit që Qeveria e Kosovës ta heqë taksën pa asnjë kusht

investime”, ka thënë Rukiqi, duke shtuar se ekonomia është duke pësuar dëme nga zhvillimet politike. “Nuk dua të hyj në debate mes partive politike e institucionale, por dua të theksoj se dëmi është bërë. Insistojmë në projeksione buxhetore. Të qartësohet skema sociale dhe të ketë investime kapitale për të krijuar kushte për zhvillim të vendit”, u shpreh ai.

Rukiqi ka folur edhe për vendimin e qeverisë, konkretisht për pagën minimale në sektorin privat që, sipas tij, kjo çështje nuk i zgjedh problemet e skemave sociale. “Kemi Ligjin e pagave që na ka krijuar një situatë të pakëndshëm duke krijuar një hendek mes sektorit publik dhe atij privat. Ky ligj do të na krijojë telashe më të mëdha. Paga minimale nuk mund t’i tejkalojë problemet sociale”, ka thënë ai. Kurse kryetari i Odës Ekonomike

Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, i ka quajtur serioze thirrjet nga senati amerikan për heqjen e trupave amerikane nga Kosova. Zeka ka potencuar se është momenti i fundit që Qeveria e Kosovës ta heqë taksën pa asnjë kusht. “Në një situatë të tillë, kur marrim paralajmërime të hapura, e që besoj se në një situatë të tillë s’kemi qenë asnjëherë në këto 21 vjet. Po ashtu, sa i përket ndërtimit të Termocentralit ‘Kosova e re’ besoj se të gjitha këto zhvillime politike e kanë lënë nën hije debitimin për termocentralin ‘Kosova e re’, realisht as qeveria e as kompania e përzgjedhur nuk janë parë të takohen ose të diskutojnë më tej. Si përfaqësues i Odës Amerikane dua ta theksoj se ka një marrëveshje në mes të Qeverisë së Kosovës dhe të kompanisë. Megjithatë, qeveria e re duhet të tregojë konsistencë në këtë

aspekt”, ka thënë Zeka, duke shtuar se temë e shqetësimit janë edhe paralajmërimet e djeshme për tërheqjen e trupave amerikane nga Kosova. “Një pjesë e madhe e gazetarëve kanë qenë të interesuar të dinë nëse është serioze situata, megjithatë është serioze, pasi paralajmërimet vijnë nga ligjvënësit amerikanë që përfaqësojnë dhomën më të rëndësishme të nxjerrës së ligjeve, që është senati amerikan dhe u tha se një paralajmërim i tillë mund të bëhet dhe nga senatorët e tjerë, gjë që edhe ka ndodhur në mëngjes. Është momenti i fundit që qeveria jonë të veprojë dhe të gjitha institucionet. Kuvendi në seancën e jashtëzakonshëm duhet të dalë me një vendim konsensual për ta tërhequr tarifën pa kushte ashtu siç kërkohet nga qeveria amerikane”, ka deklaruar Zeka.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 MARS - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi dhe drejtori i Odës Ekonomike Amerikane në Kosove, Arian Zeka, kanë mbajtur konferencë për media të mërkurën, në të cilën kanë dhënë rekomandime për dialogun publik-privat dhe nevojën për një cikël të zhvillimit të bazuar në rritjen e sektorit privat. Me këtë rast, kreu i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se situata e fundit politike është bërë pengesë e

investimeve të huaja në vend. Sipas tij, Kosova vazhdon të shtojë pikë negative në raportin e të bërit biznes. “Janë larguar investitorët nga vendi. Zhvillimet e fundit politike janë bërë pengesë e madhe për vendin, pra janë bërë barrierë e patejkalueshme në vend. Qoftë në vende të reja të punës dhe në investime të huaja. Dëmi tashmë është bërë. Kosova vazhdon të shtojë pikë negative në investime. Nuk ka asnjë lajm nga investitorët. Ne kemi krijuar një mjedis politik të paqartë dhe mos të presim që do të kemi



ASK-ja: Bie kostoja e ndërtimit në Kosovë

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e katërt (TM4) të vitit 2019.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pësoi rënie për (0.4 për qind) në tremujorin e katërt (TM4) 2019, krahasuar me TM3 2019. Rënie

më të madhe kishin kategoritë: pagat (-1.9 për qind), transporti (-1.0 për qind) dhe energjia (-0.8 për qind).

Rënia e çmimeve u neutralizua kryesisht me ngritjen e çmimeve sipas kategorive të: kostot e tjera (0.3 për qind) dhe makineritë (0.2 për qind). Ndërkaq, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit

paraprak (TM4 2018 me TM4 2019), Indeksi i Kostos së Ndërtimit është pa ndryshim (0.0 për qind).

Ngritja e indeksit kryesisht u vërejt te kategoritë: transporti (11.8 për qind), makineritë (1.3 për qind) dhe kostot e tjera (0.6 për qind). Ndërsa rënie pati te kategoritë: energjia (-2.0 për qind), materialet (-0.7 për qind)



Gjilani nis aksionin për pastrimin e liqenit të Livoçit

GJILAN, 11 MARS (ER) - Në kuadër të projektit “Dojeni liqenin tuaj”, të financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, përmes Balkan Green Foundation -

Empower Engage Build Ownership dhe të implementuar nga AZHR Lindje, këtë të shtunë, me fillim në orën 10:00, do të bëhet pastrimi i hapësirës së liqenit të Livoçit.

Në këtë aksion do të marrin pjesë përfaqësues të shumtë nga sektori i arsimit, shëndetësisë, institucioneve të ndryshme në nivelin lokal, me qëllimin e vetëm që kjo

pasuri e vlefshme të jetë një vend i vërtetë i rekreacionit dhe ambientit të pastër për qytetarët të cilët dëshirojnë ta kalojnë fundjavën pranë këtij liqeni.



Vazhdojnë punimet për restaurimin e shtëpisë së familjes Dukagjini dhe familjes Muriqi në Prizren

PRIZREN, 11 MARS (ER) - Vazhdojnë punimet për restaurimin e shtëpisë së familjes Dukagjini dhe familjes Muriqi në qytetin e Prizrenit. Krahas historikut, kjo shtëpi ka edhe një sërë vlerash ndërtimore dhe arkitektonike. Shtëpia e familjes Dukagjini dhe Muriqi është ndërtuar në shek. XIX, ndërkohë që në periudha të ndryshme janë kryer ndërhyrje restauruese. Ajo është një ndërndërtimet më tipike në tipologjitë e shtëpive tradicionale në qytetin e Prizrenit. Duke u bazuar në stilin e ndërtimit dhe tipologjitë e

shtëpive tradicionale në qytetin e Prizrenit, mund të thuhet se objekti iu përket shtëpive me sallë qendrore, kjo për arsye të rolit qendror të salloneve të katet. Sipas nevojave të pronarëve të shtëpisë, objekti është e ndarë në dy pjesë dhe sot shfrytëzohet si shtëpia e familjes Dukagjini dhe shtëpia e familjes Muriqi. Shtëpia pas ndarjes ka humbur tipologjinë e saj origjinale, por ende ruan vlerat artistike dhe arkitekturale të saj. Drejtori i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, Samir Hoxha, ka thënë se hartimi i projektit restaurues për

këtë shtëpi është një tjetër hap i rëndësishëm i politikave të Ministrisë së Kulturës për ndërhyrje restauruese në shumë asete të trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit, në kuadër të zbatimit të programit “Masat preventive, intervenimet emergjente”. Projekti i restaurimit është hartuar nga zyrtarë të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren dhe po mbështetet financiarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me ç’rast synon t’ia rikthejë shkëlqimin e munguar kësaj pasurie të trashëgimisë sonë kulturore.



Begaj vazhdon vizitat në shkollat e Malishevës, njihet me kushtet dhe mirëmbajtjen



MALISHEVË, 11 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar edhe nga shefi i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Halim Hoti, edhe të mërkurën kanë vazhduar t’i vizitojnë shkollat në disa fshatra, me qëllim të njoftimit me procesin mësimor në përgjithësi, në veçanti me kushtet që janë në shkolla, mirëmbajtjen, sidomos pas fillimit të zbatimit të masave për kujdes të shtuar ndaj koronavirusit si dhe me nevojat

që i kanë shkollat në përgjithësi. “Zbatimi i rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse shtetërore, si masa preventive ndaj virusit që është shfaqur në vendet përreth, është i domosdoshëm, po ashtu edhe mbajtja e ligjëratave për kujdesin në raport me këtë virus kanë rëndësi të madhe”, ka thënë Begaj. Gjatë këtyre vizitave që i kanë bërë në shkollat në Kijevë, Bubavec, Lubizhdë dhe Mirushë, Begaj e Hoti janë njoftuar nga drejtuesit e

shkollave apo mësimdhënësit për marrjen e këtyre masave si dhe për nevojat që kanë shkollat në përgjithësi. Është theksuar se, bazuar në gjendjen aktuale, mirëmbajtja e shkollave është në nivel të lartë dhe përgjegjësit janë duke u kujdesur maksimalisht. Po ashtu, mësimdhënësit nëpër shkolla janë duke e përcjellë edhe gjendjen e nxënësve në përgjithësi nëse kanë ndryshime si pasojë e gripit sezonal, por deri më tani nuk ka vend për panik.

Kamenica e para në Kosovë me qendër mësimore me bazë në shkollë

KAMENICË, 11 MARS (ER) - Komuna e Kamenicës bëhet komuna e parë në Kosovë me qendër mësimore me bazë në shkollë. Inaugurimi i kësaj qendre u bë nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Kamenicë, ku të pranishëm ishin kryetari i komunës, Qëndron Kastrati, drejtoresha e DKA-së, Mirhane Morina-



Bislimi, si dhe njohësi i Qendrave Mësimore, Samir Shahini.

I pari i komunës, Qëndron Kastrati, u shpreh i lumtur që hapja e kësaj qendre do të ndikojë në rritjen e cilësisë së arsimit në Kamenicë. “Objektivat tona që kanë për synim cilësinë në arsim, po fillojnë të marrin format e duhura. Vetëm me punë e përkushtim pa ndal! Falënderoj njohësin e Qendrave Mësimore

në Kosovë, Samir Shahinin, drejtoreshën Morina dhe Taskforcën e DKA-së për angazhimin për jetësimin e këtij projekti”, ka thënë Kastrati. Ndërsa hapjen e kësaj qendre e ka mirëpritur edhe drejtoresha e DKA-së, Mirhane Morina-Bislimi, e cila ka theksuar se rritja e cilësisë së arsimit në Kamenicë është prioritet për

komunën dhe DKA-në. Kurse Samir Shahini ka thënë se është shumë ndjenjë e veçantë me qenë bashkëpunëtor i një ekipi kaq të mirë tash e disa muaj. Në Qendrën Mësimore, me bazë në shkollën “Dëshmorët e Kombit”, përpos mësimit klasik, nxënësit do të mund të zhvillojnë aktivitete që do të jenë në dobi të tyre e plot atraktivitet.

Edhe një hap më afër jetësimit të Parkut të Biznesit në Polac të Ri

SKENDERAJ, 11 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe drejtori menaxhues i Agjencisë Kosovare të

Privatizimit, Valon Tolaj, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për dinamikën e realizimit të 20 për qind të pagesës së shpronësimit për

këtë projekt. “Me këtë memorandum brenda këtij viti do të realizohen të gjitha pagesat dhe kështu, me përkrahjen edhe të qeverisë, qysh tani do

ta fillojmë rregullimin e infrastrukturës për t’u hapur rrugë investimeve në komunën tonë”, ka thënë kryetari Jashari.



RËNDËSIA DHE JEHONA E DEMONSTRATAVE TË VITIT 1981

Demonstratat demokratike të vitit 1981 bënë kthesë të madhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare. Klasa politike e Kosovës e asaj kohe ishte futur në shërbim të politikës unitariste serbe. Rëndësia dhe jehona e demonstratave për Republikën e Kosovës ishte e madhe, brenda dhe jashtë shtetit jugosllav. Demonstrata dhe protesta kudo në mërgatën shqiptare. Shtypi botëror në mbështetje të kërkesave studentore!

Ismet RASHITI

Demonstratat paqësore të mars-prillit të vitit historik 1981, të cilat regjimi i Beogradit i shtypi me gjuhën e forcës policore, kanë bërë jehonë të madhe brenda dhe jashtë kufijve të ish-Jugosllavisë. Fillimi i demonstratave studentore më 11 mars 1981 dhe masivizimi i tyre më 1 dhe 2 prill 1981, duke marrë karakter popullor, ishte hapi i parë si të thuash për “zbulimin” e padrejtësive të mëdha historike që i ishin bërë popullit shqiptar dhe prapambeturisë ekonomike të Kosovës kundër republikave tjera ish-jugosllave. Me një fjalë demonstratat e vitit 1981 para opinionit ndërkombëtar shfaqën një realiteti tjetër nga ai me të cilin krenoheshin ish-Jugosllavia si “një shtet ku të gjithë popujt që jetojnë brenda kufijve të saj gëzojnë të drejta të barabarta kombëtare e njerëzore”. Për të qenë ironia edhe më e madhe, deri me fillimin e ngjarjeve të pranverës së vitit 1981, udhëheqësit komunistë jugosllav, përpiqeshin t’u jepnin mësim bashkësisë ndërkombëtare se gjoja Jugosllavia e ka zgjidhur drejt çështjen kombëtare dhe se për këtë meriton të merret model nga shumë vende të tjera.

E gjithë kjo demagogji bëhej pikërisht në kohën kur në burgjet jugosllave mbaheshin të burgosur qindra djem e vajza shqiptarë vetëm pse kishin guxuar të kërkonin hapur shkollim në gjuhën amtare, përdorimin e Flamurit Kombëtar, hapjen e Universitetit të Prishtinës dhe njohjen e statusit të Republikës së Kosovës ashtu siç ishin edhe gjashtë republikat tjera në kuadër të Federatës së ish-Jugosllavisë. Shqiptarët, pra, mbaheshin në burgje, vriteshin e akuzoheshin për fjalën e lirë, për kërkesa

paqësore që kishin të bënin për një mirëqenie më të mirë dhe që shprehnin pakënaqësinë e tyre kundër diskriminimit kombëtar, ekonomik, arsimor e kulturor karshi popujve të tjerë. Rëndësia më e madhe e ngjarjeve të vitit 1981, në planin ndërkombëtar, qëndronte në faktin se ato ishin të parat revolta të cilat sikur e “zbuluan” Kosovën dhe shprehën habinë para botës së qytetëruar e demokratike se si është e mundur që Jugosllavia e Titos e proklamuar aq shumë për barazi ta urdhëroi policinë dhe



ushtinë për vrasjen demonstruesve paqësor të cilët nuk bënë asnjë krim, përveçse kërkuar të drejtat e tyre në mënyrën më normale e demokratike. Për hir të realitetit, duhet të themi se pas këtyre ngjarjeve atë botë, klasa politike jugosllave nuk mund të pajtohej asesi me realitetin e ri që nxorën në shesh demonstratat dhe protestat gjithëpopullore në Kosovë. Në radhë të parë ishin udhëheqësit e republikave tjera joserbe të cilët edhe pse këto demonstrata, u vlerësuan nga opinioni ndërkombëtar si paralajmërimi i parë për rrezikun e pashmangshëm që po u kanosej



popujve të Jugosllavisë nga hegjemonistët dhe unitaristët serbomadhenj, ata u futën në këtë lojë të rrezikshme, duke i vlerësuar këto demonstrata si “kundërrevolucionare”, “nacionaliste”, “separatiste” etj. Për më tepër udhëheqësit më të lartë të këtyre republikave dhe autonomistët shqiptarë të Kosovës, duke mos e kuptuar, apo duke menduar se autonomia është e mjaftueshme për shqiptarët, ishin thellësisht të bindur në “drejtësinë” e politikës titiste. Kështu, pra, ishin futur me

federative që dominohej nga unitaristët serbë. Bota demokratike dhe shtypi i pavarur evropërendimor këto ngjarje nuk po i shihnin me syzet e Beogradit. Menjëherë pas gjakderdhjes ata filluan të reagojnë përmes komenteve dhe artikujve të shumtë analitik, duke informuar drejtë rreth të vërtetës që kishte ndodhur në Kosovë. Kështu pra gazeta e njohur gjermane “Frankfurter Allgemeine”, vetëm gjashtë ditë pas demonstratave, më 9 prill 1981, shkruante: “Kur u vjen uji



shpirt e zemër në shërbim të politikës shoviniste serbomadhe, e cila dal nga dal po dilte hapur në skenë. Në këtë mënyrë udhëheqësit e republikave tjera joserbe në federatën jugosllave dhe sidomos udhëheqësit autonomistë shqiptarë të Kosovës, duke i shpallur luftë të hapur kërkesës Kosova Republikë si një kërkesë sipas tyre “kundërrevolucionare”, në fakt po forconin objektivat e klanit unitarist serb në dëm të popujve të tyre.

Ngjarjet e vitit 1981, përpos rëndësisë historike në planin kombëtar, kanë edhe rëndësinë tjetër tepër të madhe në planin ndërkombëtar. Sado që shteti jugosllav aso kohe përpiqej t’i minimizonte këto ngjarje përmes intensifikimit të diplomacisë dhe mjeteve të informacionit publik, asesi nuk po ia arrinte qëllimit. E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët kishte filluar të kuptohet drejtë nga mbarë opinioni përparimtar, veçmas nga ai evropian dhe amerikan. Përdorimi i dhunës dhe gjakderdhja e shkaktuar nga forcat policore federative zbuluan fytyrën kriminale të udhëheqës

deri në fyt diktaturave fashiste të Amerikës Latine, ashtu si edhe tani vetëqeverisjes jugosllave, reagojnë siç duket në mënyrë bukur të ngjashme”. Duke folur për kërkesat e shqiptarëve kjo gazetë, shkruan se “në demonstrata doli kërkesa Kosova Republikë! Demonstruesit kërkuar që statusi i autonomisë së Kosovës të jetë i njëjti me statusin e republikave tjera që përbëjnë federatën jugosllave”. Udhëheqësit jugosllav po e paraqesin gjendjen sikur demonstratat e popullit shqiptar jenë drejtuar kundër popujve jugosllav dhe pakicës serbe në Kosovë, gjë që nuk është e vërtetë. E njëjta gazetë në një artikull tjetër të datës 27 prill 1981, i mohon kështu këto akuza të pabaza: “Të gjithë vrojtuesit vërtetojnë se demonstratat e shqiptarëve, përkundër karakterit nacional, nuk janë të drejtuara kundër pakicës serbe”.

Gazeta suedeze “Zundsvalstindling” në një artikull me titull: “Ngjarjet në Kosovë shqetësojnë shumë udhëheqësit e Beogradit”, botuar menjëherë pas demonstratave të 1 dhe 2 prillit 1981, shkruan: Demonstruesit

kritikonin shtypjen që u bëhet shqiptarëve në Jugosllavi. Ata kërkonin liri si dhe krahina e Kosovës të shpallet Republikë. Për këtë qëllim autoritetet e Beogradit, i quajtën demonstruesit “nacionalistë”, “separatistë” dhe “kundërrevolucionarë”. Nga ana tjetër gazeta amerikane “Nju York Times” e datës 27 prill 1981, veç tjerash ngjarjet e Kosovës i vlerësonte kështu: “Shteti federativ jugosllav tashmë i ka gjashtë republika. Çfarë ndryshimi do të sillte edhe një republikë më shumë? Pse Kosova të mos bëhet republikë, kur 85 për qind të banorëve të saj janë banorë etnik”? Nga ana tjetër gazeta greke “Tovina” bën këtë koment mbi ngjarjet në Kosovë: “Nuk duhet ta zvogëlojmë rëndësinë e ngjarjeve që po ndodhin në rajonin autonom të Kosovës, në kufi me Shqipërinë, edhe nëse kriza mbytet. Fakt është se autoritetet jugosllave nuk po i kursejnë mjetet e tyre mbytesë. Këto telashe përbëjnë një paralajmërim serioz...”, shprehet kjo gazetë menjëherë pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë. Ndërkaq në një koment të gjatë me titull “Kosova e varfër dhe e diskriminuar”, gazetari spanjoll Torro Riesko, në gazetën spanjolle “Avoi” shkruante: “Shqiptarët e Kosovës konsiderohen njerëz të përbuzur në Jugosllavi. Kosova është krahina më e prapambetur e Jugosllavisë dhe e gjithë Evropës. Ekziston një pabarazi e dukshme në mes Kosovës me minerale dhe republikave tjera. Që nga mbarimi i luftës reprezaljet atje kanë qenë të egra...”

Janë këto reagimet e orëve të para pas demonstratave të fuqishme të vitit 1981.

Shtypi evropërendimor në vitin 1981, çështjen e Kosovës e ka paraqitur si problem serioz që kërkon zgjidhje adekuate. Në të kundërtën kjo plagë e hapur do të paraqesë rrezik të përhershëm për shpërthimin e krizave të përgjakshme në Ballkan dhe më gjerë.

Ngjarjet që rrodhën pastaj dhe sidomos format që kishin zgjedhur unitaristët serbë për ta “mbytur” me forcë të drejtën e shqiptarëve për të qenë të barabartë me popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë, gjithsesi paraqisnin rrezik për paqen dhe stabilitetin politik në ish-Jugosllavi.

Ato ishin një paralajmërim i madh për zhvillimet e mëtuajtshme dhe synimet e politikës hegjemoniste serbe për krijimin e Serbisë së madhe dhe dominimin e saj mbi popujt e tjerë joserbë.

Këto përpjekje antishqiptare morën fund pas luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndërhyrjes së NATO-s gjatë viteve 1998-1999. Më 17 shkurt të vitit 2008, falë përpjekjeve dhe sakrificave të mëdha, Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran!



Këshilli i Federatës Ruse miraton projektligjin për ndryshime kushtetuese

MOSKË, 11 MARS - Dhoma e Lartë e Parlamentit të Rusisë, apo siç njihet, Këshilli i Federatës, ka miratuar Projektligjin për ndryshime kushtetuese, që i lejon presidentit të këtij shteti, Vladimir Putin të garojë për një mandat të pestë presidencial më 2024. Një total prej 160 deputetëve në parlament, ka votuar për miratim të projektligjit, tre persona kanë abstenuar dhe askush nuk ka votuar kundër. Ky miratim ka ardhur disa orë

pasi Duma Shtetërore, apo Dhoma e Ulët e parlamentit ka miratuar këtë projektligj në leximin përfundimtar. Kryetari i Dumas, Vyacheslav Volodin u ka thënë gazetarëve më herët se nga Putini dhe ekipi i tij i veçantë janë propozuar 390 ndryshime. Një nga ndryshimet e miratuara nga Duma Shtetërore i kthen në zero mandatet e kaluara presidenciale të Putinit, duke i dhënë mundësi atij që të garojë për një tjetër

mandat. Ky vendim rrit mundësinë për qëndrim të Putinit në pushtet deri më 2036, nëse ai fiton më 2024 dhe më pas garon sërish për rizgjedhje. Ndryshimet kushtetuese duhet të miratohen nga Gjykata Kushtetuese, mirëpo do të konsiderohen ligjshëm të miratuara nëse shumica e popullsisë i mbështet ato. Një referendum për këtë çështje është organizuar në Rusi më 22 prill.



Organizata Botërore e Shëndetësisë e shpall koronavirusin pandemi

Kreu i OBSH-së tha në një konferencë për shtyp se klasifikimi si një pandemi nuk përdoret pa u menduar mirë dhe tani ka prova se në gjashtë kontinente ka një transmetim të vazhdueshëm të virusit, që deri tani ka infektuar mbi 118 mijë njerëz dhe ka shkaktuar vdekjen e rreth 4 300 vetave në 114 vende

PRISHTINË, 11 MARS - Zyrtarët e Organizatës Botërore të Shëndetësisë thonë se përhapja e koronavirusit në mbi 100 vende kualifikohet tani si një pandemi, një klasifikim që OBSH-ja e kishte shmangur deri tani.

Dr. Tedros Adhanom Ghebreyesus, kryetari i OBSH-së, tha në një konferencë për shtyp se ky klasifikim nuk përdoret pa u menduar mirë. Por ai shtoi se "Duhet ta themi me forcë dhe shpreh. Të gjitha vendet kanë mundësinë ta ndryshojnë drejtimin e kësaj pandemie". Por tani ka prova se në gjashtë kontinentet ka një transmetim të vazhdueshëm të virusit, që deri tani ka infektuar mbi 118 mijë njerëz dhe ka shkaktuar vdekjen e rreth 4, 300 vetëve në 114 vende.

Virusi i njohur zyrtarisht si COVID-19, u shfaq fillimisht në Kinë ku zyrtarët e shëndetësisë njoftuan për 24 raste të reja të mërkurën.

Megjithatë kjo shifër shënon një rënie të vazhdueshme nga kulmi i epidemisë në Kinë, ku qeveria izoloi qytetet për të frenuar përhapjen në komunitete, vendi përballat

tani me një rritje rastesh që vijnë nga vende të tjera, ka njoftuar voa.

Pekini ka urdhëruar që gjithkush që mbërrin në Kinë, duhet të hyjë në karantinë për 14 ditë.

Italia po ndjek tani të njëjtën strategji si Kina, pasi është bërë një nga vendet me përhapjen më të madhe jashtë Kinës me mbi 10 mijë raste dhe mbi 630 të vdekur.

Pasi vendosi fillimisht kufizime për pjesën veriore të vendit, Qeveria italiane tani e ka shtrirë kufizimin e udhëtimit në gjithë vendin me 60 milionë banorë. Njerëzit mund të lëvizin vetëm për arsye urgjente shëndetësore ose pune.

Zyrtarët në ShBA po shfaqin shqetësim në rritje, ndërsa numri i rasteve ka arritur në mbi 1 mijë.

Në shtetin e Uashingtonit, ka zona me raste koronavirusi dhe guvernatori pritet të njoftojë për një ndalim të grumbullimeve me më shumë se 250 njerëz, ndërsa në shtetin e Nju Jorkut guvernatori ka vendosur që një zonë të izolohet përreth një komuniteti prej mbi 100 rastesh.



Shumë nga njerëzit që preken nga koronavirusi kanë simptoma të lehta ose të moderuara, por disa prej tyre, sidomos të moshuar dhe me probleme shëndetësore ekzistuese, janë në rrezik të sëmurës së rëndë.

Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon që njerëzit t'i lajnë duart, të mos prekin fytyrën, të mos u afrohen njerëzve që kolliten apo teshtijnë dhe të qëndrojnë në shtëpi nëse janë sëmurë.

Pas rekomandimeve për t'iu shmangur grumbullimeve me shumë njerëz, kanë sjellë si rezultat anulimin e shumë aktiviteteve në gjithë botën.

Papa Françesku drejtoi një mesazh përmes videos nga brenda Vatikanit të mërkurën dhe përfaqësuesi i Vatikanit në Timorin Lindor tha se Ati i Shenjtë nuk do të bënte një udhëtim të planifikuar atje pas disa muajsh.

Një lojë futbollit mes klubeve britanike të futbollit Manchester

dhe Arsenal caktuar për të mërkurën u shty, pasi disa lojtarë të Arsenalit dhe anëtarë të stafit, kanë hyrë vetë në karantinë pas kontakteve e pronarin e një klubi tjetër që ka rezultuar pozitiv ndaj virusit. Në ShBA, organizatorët e zhvendosën festivalin e muzikës Koaçela nga prilli në tetor. Dhe një debat të dielën mes kandidatëve presidencialë demokratë Joe Biden dhe Bernie Sanders do të mbahet pa pjesëmarrje.

Litania feston 30-vjetorin e shpalljes së pavarësisë

VILNUS, 11 MARS - Lituania ka shënuar 30-vjetorin e shpalljes së pavarësisë nga Bashkimi Sovjetik, një moment historik që ka paralajmëruar shkatërrimin e këtij organizimi.

Më 11 mars të vitit 1990, Lituania është bërë shteti i parë që ka shpallur pavarësinë, ndonëse e ka fituar atë një

vit më vonë, pasi një puç i dështuar komunist në Moskë, i mbajtur në gusht të vitit 1991, ka rezultuar me shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik në dhjetor të atij viti.

Presidenti i Lituanisë, Gitanas Nausėda, e ka cilësuar ngjarjen e zhvilluar tri dekada më parë si "mrekulli që është kthy-

er në fakt të rëndësishëm në historinë botërore të shekullit 20".

Përveç ceremonive gjatë ditës, në orët e natës pritet të organizohen marshe dhe koncerte në Vilnius dhe qytete tjera baltike. Lituania i është bashkuar NATO-s dhe Bashkimit Evropian në vitin 2004.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Akuza e një gruaje intelektuale



Shkruan: Mehmet HAJRIZI

1 Ky publikim është një protestë dhe akuzë kundër një lufte të ndyrë të fundshekullit të kaluar që bëri regjimi serb i Millosheviqit famëkeq ndaj grave dhe vajzave shqiptare në Kosovë. Institucionet e dhunës të këtij regjimi mizor kur përdhuan femrat shqiptare kishin për qëllim thyerjen morale të popullit që po i rezistonte, kur vranë 1392 fëmijë donin t'ia gjymtonin edhe të ardhmen dhe kur i dogjën 120.000 shtëpi, shpesh me njerëz brenda, bënë gjenocid, duke deportuar dhe zhbërë një popull të tërë nga vatra e vet.

2 Autorja shkrimin e saj e ka ndarë në gjashtë njësi tematike, duke filluar nga pushtimi serb i Kosovës dhe gjeneza e armiqësisë shqiptare-serbe, në thelb të së cilës janë ndarja si me thikë e atdheut shqiptar dhe kalvari shekullor i një populli të tërë e rezistenca e tij kundër aneksimit të dhunshëm. Kjo rezistencë e pashuar gati një shekull, me ngritjet dhe rëniet e saj erdhi ngadhënjyese në kapërcyell të shekullit XX, kur Kosovës iu imponua lufta e armatosur, por edhe botës demokratike intervenimi ushtarak.

Në pjesën e dytë të shkrimit paraqitet dhe analizohet vetëm njëri aspekt i luftës së forcave serbe kundër Kosovës, ai më kriminali në kuptimin shqiptar, dhunimi seksual i mbi 20.000 grave dhe vajzave shqiptare. Kjo shifër në përpjesëtim me një popullsi prej rreth dy milionë banorëve, tmerrësisht flet shumë.

Në dy pjesët vijuese autorja e trajton këtë shëmti si gjenocid biologjik, mjet lufte dhe krim kundër njerëzimit. Në dy pjesët e fundit ndërkaq, ajo fajëson faktorët e jashtëm që nuk zbatuan të drejtën ndërkombëtare për këtë krim, në një anë dhe institucionet e vendit që nuk e dëshmuan as e denoncuan atë mjaftueshëm, në anën tjetër.

Shkrimi është i pajisur me aparaturën e nevojshme shkencore, i argumentuar mirë dhe me përmbajtje të qartë e stil adekuat të të shkruarit.

3 Që nga lashtësia ka zënë fill bindja se një ushtri që si mjet dhe formë lufte aplikon përdhunimet, është e destinuar për humbje.

Kjo dhunë seksuale në stil të gjerë në Kosovë, si armë lufte e forcave serbe, dëshmon gjithë karakterin e tyre, por edhe të politikës që i drejtonte.

Një ndër virtytet e larta gjenetike të shqiptarëve, është familja, si institucioni bazë i shoqërisë. Jo rastësisht doktrina antishqiptare e përpunuar gjatë nga intelektualë dhe politikanë serbë, synonte ta godiste qenien shqiptare në palcën kurrizore; familjen, nderin, dinjitetin dhe krenarinë kombëtare.

Në shënjestër të detashmenteve sulmuese të forcave burracake dhe qyqare serbe në Luftën e Kosovës, në plan të parë ishin civilët, fëmijët, pleqtë dhe femrat. Ato jo vetëm nuk kishin moral luftarak të ndesheshin me luftëtarët e luftëtarët e uniformuar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por as moral minor njerëzor. Një ushtri që vret fëmijë me biberon në gojë dhe dhunon seksualisht gra dhe vajza të pambrojtura, është e dënuar me vdekje. Dhe jo vetëm kaq; ata duke cenuar moralin kombëtar shqiptar, vunë në bankën e të akuzuarit para historisë e ndërgjegjes së njerëzimit, brez pas brezash moralin dhe dinjitetin e kombit dhe shtetit të vet.

4 Nuk dua të besoj se kjo sjellje skizofrene është defekt a patologji kombëtare serbe, por mbaj mend një djalë birbo kriminel serb, kur ndodhesha në një dhomë me të dhe të tjerë në Burgun Hetues të Novi Sadit. E pyetën një rast kolegët e vet të dhomës, cila ishte dëshira e tij më e madhe. Prisja të thoshte ta lironin nga burgu, por jo. "Dëshiroj ta kisha një vajzë të bukur, ta përdhunoja me fuqinë e mashkullit dhe në fund ta varja për këmbësh dhe dalëngadalë ta rripja e mishin t'ia bëja copë-copë"! E dëgjoja dhe e psikologjisja, por ai fliste ftohtë, pa i kërcyer ai nervi facial në vragë dhe bënte me duar, sikur ta shkërmoqte vërtet viktimën. Më bëri të mendoja gjatë ai djalë me shpirtin e tij; prej nga kjo ide, kush ia tha, ku e lexoi, apo ishte imagjinatë morbide e vetja? Për një çast mendja më shkoi te vajzat shqiptare në një lëndinë tek po loznin si qengjat engjël-lushe... Mora ta lexoja një libër...

5 Elife Luzha, një grua e vuajtur dhe që në vajzërinë e saj të hershme e përndjekur nga regjimi për pjesëmarrje në demonstratë dhe për shpirtin liri-dashës, mastere e diplomacisë, intelektuale krijuese dhe poete e njohur, ka ngritur zërin kundër padrejtësive që u bëhen grave dhe sidomos kundër dhunës seksuale të ushtruar kundër tyre gjatë Luftës Çlirimtare. Me ndjeshmërinë e gruas nënë dhe për më shumë të poetes, Elife Luzha e trajton këtë plagë të rëndë të luftës, si një gjëmë që i kishte ndodhur Kosovës së saj. Nga gjithë tmerri dhe llahtari i këtij krimi të veçantë, ajo sjell rrefimet tronditëse vetëm të dy të rejave shqiptare, si prototipa edhe të

20 mijë të mbijetuarave të tjera që lotët si vrer gëlltisnin çdo ditë, siç thotë autorja në poezinë e saj kushtuar grave të përdhunuara. Janë megjithatë edhe 1739 gra shqiptare që nuk i mbijetuan terrorit të forcave serbe, duke u bërë therorë në themelet e lirisë së Kosovës.

Autorja bën thirrje me zërin e nënës që të mos heshtet e të dhunohet e vërteta, sepse bëhet kështu një krim i dytë mbi gratë e vajzat që përjetuan dhunimin seksual gjatë luftës, por edhe sepse ashtu pamundësohet trajtimi dhe rehabilitimi i tyre. Krimi duhet denoncuar dhe dënuar!

Ky publikim është në vazhden e kontributit të autores në këtë temë të dhembshme, për këtë plagë të pambyllur të luftës.

6 Presidenti serb, që gëzon simpati dhe përkrahje të gjerë në popullin e vet, para do kohe, në stilin e tij, përveç krimeve të tjera, e mohoi edhe këtë krim monstruoz të forcave të shtetit të vet kundër grave shqiptare.

Populli serb ka nevojë ta pastrojë këtë njollë të zezë nga biografia dhe historia e vet. Ky lavazh fillon me ballafaqimin me krimin, me kërkim faljen e sinqertë dhe me denoncimin e dënimit e tij dhe të atyre që e bënë, për gjëmën e shqiptarëve dhe të zezën e vetë serbëve. Sa më parë, aq më mirë.

(Teksti është parathënie e librit "Dhuna seksuale nga forcat ushtarake policore serbe ndaj grave shqiptare gjatë luftës në Kosovë", të autores Elife Luzha)





VIOLETA ALLMUÇA

PËRJETËSIMI LETRAR

Krijuesi, qysh kur ka filluar të shkruajë një libër, ka zbuluar brenda botës së madhe edhe një botë tjetër, që quhet bota e tij e artit për ta publikuar në botën njerëzore. Mendimit për të sjellë një vepër artistike, poezi apo roman, me synimin e rrëfimit të vetes, hapësirës dhe kohës së jetës së krijuesit, i përgjigjen sistematikisht disa pyetje të vështira. A e ka zhvilluar ky libër majën e thurjes së mendimit e vlerësimit? A e ka ky libër rrjedhën e vështrimit dhe studimit kritik? A janë disa rezultate në pajtim ose mospajtim me shkrimin e një libri që lidhen si një tërësi rezultatesh apo një vizion dhe fantazi e shkrimtarit? Çfarë ndodh me rivlerësimin e të tjerëve, për atë që i paraqet lexuesit? Letërsia e mirëfilltë, si gjithmonë për të qenë objekt i mendimit artistik, duhet pranuar që duke pasur koherencën letrare, t'i shpallë lidhjet pa komplekse të dialektikës mes krijimit dhe mendimit. Po ashtu, koncepti i interpretimit dhe shqyrtimit duhet kuptuar si një veprim letrar dhe ndërveprim studiuesish.

Veçantitë e shkrimit të një libri mbështeten në çështjet e tërësore dhe shpirtërore, ku dëshmohet veprimi i fushës së ekzistimit të një vepre po aq letrare, sa edhe mendimi për realizimin e sistemit analitik dhe estetik. Tërësia e strukturës së një vepre letrare mund të kuptohet nëse lënda e krijimit përmbush kuptimin e drejtë të shkrimit. Në fund të fundit pyesim: A e pranojnë shkrimtarët se kanë nisur të bëjnë një vepër letrare me një kombinim të përbashkët krijues dhe studiues? A duhet të bashkohet dokumenti i krijuesit me veprimin hulumtues dhe kritik? Studimet e mëtejshme në kohët e sotme, ndërsa e ngritin lart

funksionin e krijimit artistik, i kujtojnë autorit të mos harrojë edhe funksionin estetik apo mendimin letrar, në radhë të parë, të lexuesit që strukturën e asaj çka lexojnë duan ta ndiejnë në tërësinë e tyre shpirtërore. Letërsia e Rilindjes Kombëtare jo vetëm që shkruhej shqip me idenë e çlirimit kombëtar, jo vetëm i mëshonte bashkimit kombëtar, por ajo pati jehonë në epokën e saj, megjithëse momenti artistik, veçanërisht në poezi, nuk ishte dominues. Formësimi si art letrar shfaqet pas viteve '30, ndërsa pas vitit '45 arti dhe krijimi u kthyen në përkrahës të ideve ideologjike gjatë rendit shoqëror të kohës, ku spikati edhe letërsia, e disidentëve të regjimit, si Kasem Trebeshina, Visar Zhiti, Bujar Xhaferrit etj., veprat e të cilëve morën edhe vëmendjen e kritikës dhe studimeve letrare që i quajti edhe "disidentë" estetikë.

Botëkuptimi mbi artin dhe letërsinë pas viteve '90 nxiti prodhimin artistik dhe mori hov, përkundër heroizmit të lirisë, ndërsa ra në sy numri i madh i krijuesve në shoqërinë shqiptare të kohës. Ndryshimi i dukshëm i strukturës krijuese me ndërrimin e mendimit, reflektimit mendor dhe shpirtëror, kërkoi të ishte i qenësishëm në tërësinë krijuese dhe pak e pohuar në sferën e mendimit kritik. Sot kemi një tip tjetër krijuesi që sjell një formë të re, një stil të ri, që kemi pasur privilegj ta konstatojmë si një përvojë të re.

Sot gjithçka letrare ose joletrare lejohet, mu siç edhe pritej, sepse edhe liria ishte qëllim në vetvete. Jetët dhe fatet njerëzore në mënyrë të vetëdijshme po sjellin sot edhe krijuesit e socrealizmit në veprat letrare si përsëritje të rrëfimit në kuptimin e kohës së re. Po ashtu, edhe kri-

juesit e pas viteve '90 kanë rritur sasinë e botimeve, duke pasur si kuptim vetëm iluzionin e të qenit vepër letrare, sipas frymës estetike. Mendimi kritik çuditërisht ende mungon. Tipi i krijuesit të sotëm që ka thyer zinxhirët e së shkuarës në diktaturën komuniste, i cili synon shpallimin estetik nëpërmjet gjuhës artistike, vijon ta rikrijojë lëndën e tij, jashtë konceptit dhe përvojës që ka ekzistuar, në zbulimin e heroit dialektik dhe ligjeve të mohimit të "heroit" të shkuar, si "anti-heroit" i sotëm. Por, ashtu si jeta njerëzore shkon në vazhdimësi, edhe fjala artistike ndjek rrugën e vet. Shkrimtari i sotëm e vendos prototipin letrar si një objekt mohues, dobia e të cilit, meqë nuk ka përligjur lirinë, e kthen në tendencë jashtëkohore. Letërsisë që i thyhen prangat shpirtërore me ndërjegjen e lirisë e bën dukshëm të arsyeshëm ndjeshmërinë e krijuesit që lëshohet vullshëm sipas përvojës së tij morale, estetike dhe artistike. Tipari i krijuesit të sotëm, meqenëse në art duhet të mbizotërojë estetika, e ka kthyer interpretimin e veprës letrare në rrafshin e "vetëreklamës" duke e menduar librin si një "kryevepër" të tij, pa mendimin kritik dhe studimor, nëse ajo është dhe do të mbetet një vepër letrare e vërtetë.

Veprat e Naim Frashërit, Jeronim de Radës, Ndre Mjedës, Asdrenit etj., me theks romantik gjithëherë përmes poezisë, sollën libra me tematikë kombëtare dhe identitet kombëtar. Ndaj veprat e tyre, përvoja krijuese, hulumtimi i gjatë, përfshirë edhe mendimin kritik të mëvonshëm, siç bëri Konica edhe si kritik letrar, Fishta, Çajupi, Fan Noli etj., tërhoqën vëmendjen e lexuesit. Lasgush Poradeci vjen me poezinë lirike moderne

shqiptare duke vlerësuar edhe anën estetike të veprës letrare. Ai ka arritur në nivelin e vetëdijes deri te lexuesit e sotëm, edhe pse nuk shkroi me metodën e realizmit socialist. Veprat e shkrimtarëve të Rilindjes Kombëtare (1836-1912) mbeten edhe pas 183 vjetësh gjithnjë të lexueshme deri në ditët e sotme, pasi duket se e kanë arritur përjetësimin letrar.

Letërsia pas vitit '45, për afër gjysmë shekulli si pasqyruese e një kohe letrare, ishte në shërbim të ideologjisë së realizmit socialist. Me misionin e artit "popullor", me parimin e letërsisë së partisë, në aspektin bashkëkohës, krijuesin intelektual apo të "klasës" punëtore e shtynte në dhënie të një interpretimi anësor që i shërbente dhe ishte i përshtatshëm për regjimin. Veprat e Dhimitër Shuteriqit, Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit e të tjerëve, edhe pse kishin afër kritikën e kohës, si reflektim që e plotësonte këtë mision, kjo letërsi nën totalitarizëm nuk do të ishte e lirë. Lënda shpirtërore dhe liria e krijuesit ishin "vdekjeprurëse" në aspektin e krijimit dhe interpretimit të veprës ashtu siç u rrënuar edhe fjala hyjnore. Ndaj kjo letërsi, me përjashtim të pak krijuesve, nuk arriti të shfaqet si letërsi përjetësuese. Kujtojmë këtu se vepra e Kadaresë u ekuilibruar pas suksesit universal edhe në letërsinë shqipe. Dritëro Agolli mbeti shkrimtari më origjinal që iu qas lexuesit popullor me veprën e tij. Çështja e atëhershme mbetej të mos përulej sistemi. Jo të gjithë shkrimtarët ndoqën metodën e socrealizmit siç ishin: Jakov Xoxa, Frederik Rreshpja, Zija Çela e të tjerë, të cilët sollën vepra me elemente realiste e ndjeshmëri moderne në poezi e prozë.

Kritika letrare e kohës e shënjoji këtë moment si një përshkallëzim vlerash në krijimtarinë me frymën e kohës. Regjimi me misionin e tij mundi ta gjymtonte lirinë e çdo krijuesi që nuk i shërbente historisë së monizmit. Megjithatë letërsia e realizmit socialist me prurjet në poezi e prozë duhet studiuar me vëmendje për vlerat dhe antivlerat letrare, dhe jo vlerat ideologjike. Vlera përbëjnë ato vepra që lexohen edhe sot, që do të lexohen nesër dhe në të ardhmen si një letërsi e mirëfilltë.

Pluralizmi i ideve pas viteve '90 krijoi një letërsi ku dominoi përpjekja për ta sublimuar lirinë me vepra polivalente. Shkrimtarë të njohur si Fatos Kongoli, Luljeta Lleshanaku, Ervin Hatibi, Fate Velaj e të tjerë kanë sjellë vepra të reja ku frymon plotësisht liria e munguar, një letërsi moderne, drejt një stili individual, ku shihen vlerat estetike, liria shpirtërore, një formë e re dhe një përvojë universale.

Sot botohen libra pafund. Për fat të keq, nga të ashtuquajturit "kritikë" shkruhet përgjithësisht për çdo vepër letrare, duke lënë në hije edhe ndonjë krijues të vërtetë. Shumë pseudoshkrimtarë e kanë kthyer fushën e letrave në një duel, ku veshjes artistike dhe lëndës letrare nuk i vishet mendimi kritik dhe estetik. Hulumtimi i faktorëve sa artistikë dhe estetikë, mendimi mbi veprën apo vlerën e një libri, mjeshtëria e shprehjes artistike e të tjera, kur letërsia merr vlerën e artit, vetëm studimet letrare dhe rrjedha kritike mbeten një argumentim përbërës që çon në përjetësinë e veprës letrare. Ndoshta do të duhet shumë kohë të evidentohen vlerat artistike dhe estetike të letërsisë së sotme që dallohet nga letërsia shqiptare e mëparshme. /Revista "Akademia"/



REALIZMI MAGJIK: MAGJI APO LOJË MASHTRUESE?

**Nga: Fortino Corral
RODRÍGUEZ
Përktheu: Bajram
KARABOLLI**

Realizmi magjik përbën një pikë kulmore të shprehjes letrare latinoamerikane. Zbulimi i identitetit të saj, i dalluar prej kulturës evropiane, fillon shumë më përpara lëvizjes emancipuese që ndodh përgjithësisht në fillim të shekullit XIX; njëherësh e konsumuar, pavarësia e shprehjes nacionale dhe amerikaniste, merr karakter të programit zyrtar. Më 1842, Viktorino Lastarria nxiste shkrimtarët kilianë me këto fjalë: “Forca është të jemi origjinalë; të kemi brenda shoqërisë sonë gjithë elementët për të qenë të tillë, për ta kthyer letërsinë tonë në një shprehje autentike të nacionalitetit tonë” (f. 18).

Romani i shekullit XIX zhvillohet nën këtë moto, dhe merr përsipër veprimtarinë intelektuale të angazhuar në zhvillimin shoqëror të kombësive të reja. Romani arrin të bëhet kështu regjistër historiografik, ligjëratë politike, kritikë e zakoneve, predikim moralizues, dhe, së fundi, dokument denoncimi, gjithçka që përkufizon mënyrën e saj për të qenë realiste.

Në epokën bashkëkohore, domethënë, nisur nga dekada e dytë e shekullit XX, ndikimi i

avangardistëve lëkund themelet e realizmit pozitivist dhe përhap elementin irracional. Qysh në vitet '20 të shekullit në fjalë dalin në dritë tekste narrativë me nota avangardiste si “Kafja e askujt” i Arkeles Velas (Arqueles Vela), “Roman si re” i Hilberto Ovenit (Gilberto Owen), që me vështirësi mund të konsiderohen si fillimi i këtij transformimi nga ajo pak gjurmë që lanë në kohën e tyre; në fakt, kritika sapo nis t’u kushtojë vëmendjen që meritojnë. Risia nuk mund të ndodhte si një zëvendësim drastik i një forme me një tjetër, por si një integrim i së vjetrës me të renë, në këtë rast, të realizmit tradicional me ndihmesat avangardiste.

Rezultati i një neorealizmi që shfaqet me etiketa të ndryshme, sipas stilit që mbizotëron: surrealist, ekzistencializëm, psikologji, mit, fantazi, simbolizëm, mendim magjik. Në vija tejet të përgjithshme, ky ndryshim paraqitet si një triumf relativ i lokalizmit tradicional, i ashpërsuar në periudhën krijuese* apo vendalje, dhe qëndron në ngritjen e rëndësisë së ndërtimit formal në lartësinë e përmbajtjes tematike që, për më tepër, zhvillon edhe zgjedhjen e motiveve apo çështjet e njëjtësuar me letërsinë universale.

Spektri i ri narrativ, fikcioni fantastik, i kultivuar kryesisht nga Horhe Luis Borhes (Jorge Luis Borges) figuron si një

qëndrim sfidues në poetikën realiste, për çfarë do të bëhet objekt akuzash si përlulesi para gjërave të huaja apo si artificiale, damkë të cilën do ta vuante gjatë disa dekadave. Shumë pranë poetikës fantastike, por më fatlume në formulimin e vet ideologjik, gjenden poetikat e “reales së mrekullueshme” dhe ato të “realizmit magjik”, ku mjeshtëria avangardiste evropiane është zëvendësuar, siç e vë në dukje Emil Volek, nga mitologjia autoktone e popujve amerikanë e plotësuar edhe me trashëgiminë afrikane.

Kritika akademike angazhohet pak vonë me këtë problematikë. Referenca e parë e këtij lloji është artikulli i Anhel Flores (Angel Flores), “Realizmi magjik në rrëfimin hispanoamerikan”, publikuar në vitin 1955 në revistën Hispania. Aty vlerësohet realizmi magjik si një transformim artistik me dimensione të mëdha që i kapërcen hapësirat latinoamerikane: “Duke ndeshur te realizmi fotografik një rrugicë pa dalje, të gjitha artet – në veçanti piktura dhe letërsia – reagan kundër tij, dhe shumë shkrimtarë të shquar të periudhës së Luftës së Parë Botërore zbuluan simbolizmin dhe realizmin magjik” (f. 19).

Këtë risi, A. Flores e quan si një “amalgamë të realizmit dhe fantazisë” (f. 20) dhe ofron si shembull paradigmatic narracionin e Kafkës. Kritiku

vendos vitin 1935 si datë të fillimit të realizmit magjik në Hispanoamerikë, në referencë të qartë me botimin e “Historisë universale të poshtërsisë”; ai konsideron se dekada pasardhëse, që përfshin vitet midis 1940-ës dhe 1950-ës, është ajo e lulëzimit më të madh të tij, brenda së cilës shquhet një plejadë shkrimtarësh, shumë prej të cilëve, më vonë, do të bëhen të njohur më shumë me letërsinë fantastike se sa me realizmin magjik: Adolfo Bioy Kasares, Silvana Okampo, Hose Bianco (Juan Bianco), Huan Hose Arreola (Juan José Arreola), Francisko Tario, Felisberto Hernandez, Hulio Kortasar (Julio Cortázar), midis të tjerëve.

Do të kalonin edhe dymbëdhjetë vjet, që artikulli i Anhel Flores të merrte një përgjigje akademike. Këtë ia dha Luis Leali më 1967, me një artikull që përsërit titullin e Floresit: “Realizmi magjik në letërsinë hispanoamerikane”. Leali pohon se termi “realizëm magjik” që përdorur nga Franc Roh, qysh në 1925, për t’iu referuar rrymës post ekspresioniste në pikturë, veçoria e së cilës, sipas tij, qëndronte në atë që “misteri nuk vjen në botë në mënyrë të dukshme, por fshihet dhe regëtin në të” (f. 231). Leal zbulon gjithashtu se i pari njeri që ka përdorë këtë togfjalësh në Hispanoamerikë ka qenë shkrimtari venezuelas Arturo

Uslar Pietri, i cili e përdor në tregimin venezuelas (f. 232) për të emërtuar “konsideratën e njeriut si një mister brenda të dhënave realiste”. Në të njëjtin artikull, Luis Leal rivlerëson poetikën e “reales së mrekullueshme” që formulon Karpentieri te prologu i romanit të tij “Mbretëria e kësaj bote” (1949) dhe e bën të përkohë plotësisht me “realizmin magjik”. Së fundi, përjashton si Kafkën dhe Borhesin nga kjo poetikë.

Polemika arrin momentin e vet të pjekurisë në mes të viteve shtatëdhjetë, kur në vitin 1975, në Universitetin të Miçiganit, zhvillohet Kongresi XVI i Institutit Ndërkombëtar të Letërsisë Iberoamerikane, i cili kishte si temë të përgjithshme “Fantazia dhe realizmi magjik në Iberoamerikë”. Një precedent i rëndësishëm është publikimi i librit “Hyrje në letërsinë fantastike” i Cvetan Todorovit (1970), i përkthyer në spanjisht dy vjet më vonë. Është vendimtare saktësia që arrin formalisti në përcaktimin e fantastikes: “Së pari – thotë ai -, është e nevojshme që teksti e detyron lexuesin për ta konsideruar botën e dy personazheve si një botë personash real dhe të lëkundet midis një shpjegimi të natyrshëm dhe një shpjegimi të mbinatyrshëm të ngjarjeve të përjetuara” (f. 30).

Dallimi midis realizmit magjik dhe letërsisë fantastike thjesht

lakmon të niset nga ky përcaktim. Tregimet, në të cilat ngjarja e jashtëzakonshme shkakton qartë dyshim apo habi, do të ishin fantastike, ndërkohë që, përkundrazi, pranimi i së jashtëzakonshmes si pjesë e rregullit të përditshëm do të presupozonte efektin magjikorealist. Ky deduksion imediatist del në pah në disa nga punimet që u paraqitën në kongresin e lartpërmendur, i cili, siç mund ta vëmë re menjëherë, u fut në një rrugë pa krye. Ndërsa hendeku i dallimit me gjininë fantastike qëndron, disa studiues parapëlqejnë të bëjnë krushqi midis “realizmit magjik” dhe “gjinisë së mrekullueshme”, meqë e jashtëzakonshmja nuk shkakton pështjellim apo dyshim as te personazhet e as te zëri narrativ, veç se pranohet si pjesë e së përditshmes; megjithatë, ekziston një ndryshim themelor midis teksteve të identifikuar si magjikorealist dhe përrallave: këto të fundit inskenohen në një hapësirë-kohë jashtëhistorike, ndërkohë që të parat gjenden të vendosura në kornizën e kohës dhe hapësirës latinoamerikane.

Duke pasur parasysh se tezat e Todorovit dhe të studiuesve të tjerë si Caillois dhe Vax të shpien qartësisht në korpusin fantastik të shekullit XIX, rezultojnë mjaft bindëse të mendosh në mundësinë e një varianti bashkëkohor të letërsisë fantastike që konsiston pikërisht në atë që e jashtëzakonshmja bëhet njësh me rregullin e përditshëm, pa shkaktuar kurrfarë shtangie apo habie te personazhet. Ky nocion konkretizohet më vonë me termin “neofantastike” që Haime Alazraki (Jaime Alazraki) propozon për të shpjeguar “kortazarizmin fantastik” dhe që merr Kafkën si referencë paradigmatisht. Po një koncept i tillë përputhet pikërisht me atë që Anhel Flores e kishte përkufizuar në mënyrë origjinale “realizmin magjik”, emërtim që fillon të bëhet i paqëndrueshëm, për çfarë vetë Flores pranon ta braktisë dhe, në vend të tij, të përdorë “letërsia fantastike”.

Megjithatë, disa kritikë si Seymour Menton insistojnë në mbajtjen e këtij koncepti internacionalist të realizmit magjik dhe shohin te Franz Roh kritikun themelues të tij. Menton e aplikon termin në një tërësi të rëndësishme veprash dhe autorësh perëndimorë, midis të cilëve figurojnë disa hispanoamerikanë si Garsia Marques (Garcia Marquez), Borhes, Arreola, Kortázar... Parashikimi i tij e shpie në gabime të papranueshme, duke e klasifikuar “Pedro Páramon” e Huan Rulfos (Juan Rulfo) brenda letërsisë fantastike “nga fakti se të vdekurit flasin dhe veprojnë” (f. 206) dhe duke konsideruar “Njeriun e vdekur” të Horasio Kirogës (Horacio Quiroga) si tregimin e parë magjikorealist të letërsisë botërore (f. 227).

Ky koncept për realizmin magjik nuk e përfill mendimin

kritik që është dhënë në botën hispanike gjatë dekadave të fundit rreth letërsisë fantastike dhe që gjejnë te Jorhe Luis Borhes një nga themeluesit më të famshëm; gjithashtu, nuk e përmend publikimin e “Antologjisë së letërsisë fantastike” të përgatitur nga Borhes, Bioy Kasares dhe Silvina Okampo (1940), libër që vjen për të qenë një lloj shpalljeje në favor të këtij aspekti letrar; po ashtu nuk ka njohje për identifikimin e qartë të Hulio Kortázarit me rinovimin e kësaj gjinie dhe as për kontributin e autorëve si Karlos Fuentes, Huan Hose Aurreola, Elena Garro, Rosario Ferré, midis shumë të tjerëve. Por, si ta dallosim këtë narracion të ri fantastik nga realizmi magjik?

Më duket se shembullin na i jep Walter Mignolo kur thotë se termat “realizëm magjik” dhe “realizëm i mrekullueshëm” “përdoren për t’iu referuar njëfarë tipi letërsie shumë ideologji [sic] i korrespondon kërimit të amerikanitetit. Në këtë kuptim, kur shprehja “realizëm magjik” përdoret në kontekstin latinoamerikan, duhet kufizuar konteksti i saj i përdorimit” (Planells, f. 14). Atëherë, dallimi që propozoj, midis letërsisë fantastike dhe realizmit magjik është se në fiksonet magjiko-realiste elementët e jashtëzakonshëm apo të mrekullueshëm i përgjigjen kozmovizionit të gjithë komunitetit – autokton apo metis – të rrethuar nga gjeografia amerikane. Në përputhje me këtë kriterdo të qëndronin nën veçorin e realizmit magjik, midis të tjerave, vepra si këto: “Njerëz misri” (1949) e Migel Anhel Asturias (Miguel Ángel Asturias), “Në vijën e ujit” (1947) e Agustin Janjes (Agustín Yáñez), “Pedro Páramo” (1955) e Huan Rulfos, “Njëqind vjet vetmi” (1967) e Gabriel Garsia Marques, “Kujtimet e së ardhmes” (1963) e Elena Garros. Për ta saktësuar më mirë këtë propozim, tregimi “Faji është i talksaltekasve”, njësoj si dhe “Çak Moli” të Karlos Fuentesit apo “Festa e mrekullueshme” e Hose Emilio Paçekos (José Emilio Pacheco), megjithëse të vendosura në kulturën indigjene prehispanike, i përkasin fare mirë gjinisë fantastike për të predominuar në ta perspektiva racionaliste dhe për të çuar një përvojë të tipit individual, para një përvoje kolektive.

Në tekstin magjikorealist, rrëfyesi – ose autori i nënkuptuar – pa e vënë fare në diskutim, aprovon pikëpamjen e popullsisë apo të komunitetit që e rrethon. Ky aspekt formal e dallon “realizmin magjik” nga “realja e mrekullueshme”, pasi në këtë rrëfyesi ruan një distancë strategjike, sado e vogël qoftë, prej të rrëfyerit. Seymour Menton (f. 162-170) vë re këtë dyfaqësi perspektiviste, me të cilën paraqitet e jashtëzakonshmja te “Mbretëria e kësaj bote” e Karpentierit. Nga ana e vet, Vargas

Llosa (“realja e mrekullueshme...”) detajon mjetet stilistike që ndërhyjnë midis të dhënave historike dhe gjeografike ku, sipas gjasës, rrethshkruhet romani dhe forma artistike në të cilën artikulohej për të prodhuar efektin e mrekullueshëm.

Siç dihet mirë, në prologun e këtij romani, Karpentieri shfaq poetikën e reales së mrekullueshme, e cila bazohet tek ideja se e mrekullueshmja është pjesë përbërëse e realitetit amerikan. Besimplot në këtë parakusht, skualifikon fantazinë evropiane duke qenë se krijohet “me truke prestigjatori, duke bashkuar objekte që zakonisht nuk gjenden bashkë: historia e vjetër dhe mashtruese e të gjeturit, rastësisht, të ombrellës dhe makinës qepëse mbi një tryezë operimi” (f. 13).

Realizmi magjik, në konceptin e tij amerikanist, bie në vetë tundimin për ta ngjizur të magjishmen si një veçori objektive të përditshmërisë amerikane. Gabriel Garsia Marques, eksponenti i tij më i njohur, këmbëngul në këtë vlerësim:

“Jeta e përditshme në Amerikën Latine na tregon se realiteti është plot me gjëra të jashtëzakonshme. Në këtë drejtim, më ndodh shpesh të citoj eksploratorin amerikanverior F. W. Up de Graff, i cili në fund të shekullit XIX bëri një udhëtim të pabesueshëm përgjatë botës amazonase ku, midis të tjerave, pa një përrua me ujë që ziente dhe një vend ku britma e njeriut shkakonte rrebesh shiu.” (f. 36).

Lind pyetja se sa e përfaqëson përditshmërinë latinoamerikane ky vend i mrekullueshëm i vizituar prej eksploratorit amerikanverior. Si realizmi magjik ashtu edhe realja e mrekullueshme kërkojnë të artikulojnë dhe të miratojnë një vizion për botën, të ndryshëm nga ai që ka qytetërimi perëndimor, për të cilin kthehen drejt substratit legjendar dhe mitik të kulturës autoktone dhe afrikane. Megjithatë, është e nevojshme të zbulosh se ajo për të cilën bëhet fjalë është një sendërgjim artistik, pa dyshim, tërësisht i vlefshëm, dhe jo për një reflektim pasiv të asaj që do të ishte një realitet objektivisht i mrekullueshëm.

Si shembull kemi një nga ndodhitë magjiko-realiste më të potershme të treguara te “Njëqind vjet vetmi”: ngjitja në qiell e Renatës, së bukurës:

“... derisa një mbasdite marsi, kur Fernandoja deshi të nderte çarçafët prej liri në kopsht dhe për këtë u kërkoi ndihmë grave të shtëpisë. Sapo kishin filluar, kur Amaranta vuri re se Renata, e bukura, qe bërë dyllë e verdhë në fytyrë.

– Nuk ndihesh mirë? – e pyeti.

Renata, e bukura, që e mbante çarçafin nga ana tjetër, lëshoi një buzëqeshje dhembshurie.

– Përkundrazi, – tha, – kurrë nuk jam ndier më mirë.

Me të thënë këtë, Fernanda ndjeu se një erë e hollë driteja

hoqi çarçafët nga duart dhe i nderi përsëri plotësisht. Amaranta ndjeu t’i fërfëllin në mënyrë misterishme dantelat e fundit të saj të gjatë dhe u mundua të kapej te çarçafi që të mos binte, kur pa se Renata, e bukura, po ngrihej lart. Ursula, tashmë pothuaj e verbër, e vetmja që ruajti qetësinë për të zbuluar karakterin e asaj ere të pandalshme, i la çarçafët në mëshirë të dritës dhe shikonte Renatën që po thoshte lamtumirë me dorën përpara fërgëllimës vezulluese të çarçafëve që ngriheshin bashkë me të...” (f. 250 – 251)

Në intervistën me Plinio Apulejo Mendosën (Pilino Apuleyo Mendoza), Garsia Marques tregon për vështirësitë që pati për ta fiksuar realitetin e ashpër në këtë ngjarje:

– Jo, nuk ngrihej. Unë isha i dëshpëruar sepse nuk kishte mënyrë ta bënte të ngrihej. Një ditë, duke u menduar për këtë gjë, dola në oborrin e shtëpisë sime. Frynte shumë erë. Një zezake shumë e bëshme dhe shumë e bukur që vinte për të larë rroba, po mendohej të nderte çarçafët në një tel. Nuk po i nderte dot se ia merrte era. Atëherë pata një dritësim. “Ja, u bë”, mendova. Renata, e bukura, kishte nevojë për çarçafët që të ngjitej në qiell.” (f. 37 – 38)

Pra, autori duhet t’i drejtohej një tip loje mashtrimi e mbështetur te çarçafët, era dhe dritat për të arritur efektin optik të kërkuar. Rasti është veçanërisht interesant për analizën sepse, veç kësaj, informon mbi reagime të ndryshme në ngjarjen që i përket besueshmërisë të tij. Të huajt “menduan se Renata, e bukura, më në fund, i qe dorëzuar fatit të saj të parevokueshëm të bletës mbretëreshë dhe se familja e saj përpiquej të shpëtonte nderin me gënjeshtrenë e fluturimit në ajër”. Fernanda “e brejtur nga zilia, përfundoi duke e pranuar mrekullinë”, gjë që tregon se, thellë në zemër, ajo e besonte. Dhe së fundi, e dimë se shumica “besuan te mrekullia, madje ndezën qirinj dhe u lutën gjatë të nëntave” (f. 250).

Nëse do t’i përmbahemi idesë se magjikorealizmi, në radhë të parë, është jashtëletrar, do të duhej të hamendësonim se shumica e hispanoamerikanëve do të pranonte vërtetësinë e ngjitjes së çuditshme të Renatës, së bukurës, në qiell. Megjithatë, në të njëjtën intervistë, Garsia Marques thotë se ngjarja reale që e motivoi këtë episod qe ajo e “një zonje, mbesa e së cilës ia kishte mbathur një mëngjes herët dhe se për ta mbajtur të fshehtë këtë, zonja vendosi të përhapte lajmin sikur e mbesa qenësh ngjitur në qiell” (f. 37), gjë që përkon me shpjegimin racionalist që japin të huajt në roman.

Mario Vargas Llosa parashtron këtë strategji si një kontrpunkt perspektive midis rrëfyesit dhe së rrëfyerës: “rrëfyesi hidhet tek imagjinaria për të rrëfyer realen objektive dhe te realja objektive për të rrëfyer imagjinaren” (Histori, f. 565). Gjithsesi, Garsia

Markes ngul këmbë se bota trilluese e romanit të tij është shumë e ngjashme me jashtëletraren: “Njoh njerëz nga populli i thjeshtë – thotë -që kanë lexuar “Njëqind vjet vetmi” me shumë dëshirë dhe me shumë kujdes, por pa ndonjë habi, sepse, në fund të fundit, nuk u tregoj asgjë që nuk i ngjan jetës së tyre” (Biseda, f. 36). Ky lloj pohimi, sipas mendimit tim, të shpie në keqkuptime të pathemelta. Më duket se ideja e largët është të theksojë se bota trilluese e romaneve të tij nuk është produkt i një fantazie të thjeshtë, “a la Disney”, por një eksplorim i reales me imagjinatë. Në këtë kuptim, poetika e tij shprehet më mirë në këtë deklarimin tjetër: “Po. Besoj se një roman është një paraqitje e koduar e realitetit, një lloj gjëze për botën. Realiteti i stisur në një roman është ndryshe nga realiteti i jetës, edhe pse mbështet në të. Siç ndodh edhe me ëndrrat” (f. 35 – 36).

Për të bërë një përmbledhje të atyre që janë thënë më lart, duhet që realizmi magjik, në kuptimin e tij amerikanist, të mos rezultojë i një cilësie magjike i realitetit amerikan, por që të përbëjë një procedim letrar, një veprim loje mashtrimi me imagjinatë, një Kristal të punuar nga magjistarët amerikanë (shkrimtarët) për të interpretuar botën e tyre dhe atë të huaj. Realizmi magjik ngjan me format e tjera shprehëse, siç është fantastikja apo surrealistja në shtjellimin e saj më të lartë të imagjinatës, por dallohet prej tyre për t’u integruar si një vizion i botës kolektive dhe identitare. Këto veçori profilojnë realizmin magjik si një poetikë subversive që pajton në mënyrë krijuese sferat e fantazisë me realitetin dhe e bën imagjinatën një armë të domosdoshme të emancipimit ideologjik.

*krijoste, nga krijajo (criollo) – në Amerikën Latine kështu quhen ata që kanë lindur atje, por që nuk janë as indigjenë as të huaj. Pra epoka krijoste, do të thotë epoka kur u krijua popullsia vendase me origjinë nga ardhësit prej vendeve të tjera.

Dr. R. Fortino Corral Rodriguez – studiues dhe hulumtues meksikan. Ka studiuar për Literaturën Hispanike në Universitetin e Sonoras. Ka marrë doktoratën në Universitetin e Arizonës me tezën “Rrëfimi fantastik në Meksikë: Epoka moderne”. Aktualisht është profesor me kohë të plotë në Departamentin e Letrave dhe Linguistikës në Universitetin e Sonoras. Drejton revistat ConNotas dhe “Revista e kritikës dhe teorisë letrare”. Ka botuar “Rruga kritike” dhe “Studime për letërsinë hispanoamerikane” (2007). Është anëtar i Sistemit Kombëtar të Hulumtuesve. Sferat e interesit të tij, midis të tjerave, janë letërsia meksikane, gjinia fantastike dhe didaktika e shkrimit krijues.

/Revista “Palimpsest”/

E rrallë

Gjirafat e bardha dhe shumë të rralla vriten nga gjuetarët në Keni

Ato ishin ndër gjirafat më të rralla që kanë ecur në këtë planet dhe tani ato janë zhdukur. Mbetjet e dy gjirafave mahnitëse të bardha që jetonin në një vend të shenjtë të kafshëve të egra në Kenia iu gjet vetëm skeleti i tyre. Gjirafa nënë dhe i vogli i saj u vranë nga gjuetarët, thanë autoritetet në Kenia. Shërbimi i kafshëve të egra në Kenia u thirr në rezervë pasi u raportua se gjirafat nuk ishin parë brenda një kohe të gjatë. Pas gjetjes së eshtrave, zyrtarët e jetës së egër vlerësuan se ata kishin qenë atje për të paktën katër muaj.



FOTO E DITES



Një aeroplan kalon para hënës së plotë në Brazil. /AFP/

E jashtëzakonshme

Bukuria misterioze e 'Shkretëtirës Mojave', fotografi kaloi 16 vjet për t'i kapur imazhet

Bukuria misterioze e 'Shkretëtirës Mojave' është kapur me imazhe mahnitëse e në të njëjtën kohë këto pamje duken shqetësuese. Fotografitë janë realizuar për 16 vjet nga fotografi Zach Bradley, i cili u rrit në shkretëtirën prej 25 mijë kilometrash katrorë. Ai në këto imazhe ka paraqitur makina të braktisura, shtëpi të zbrazëta dhe varreza të frikshme, ndërsa eksploronte mjedisin e ashpër.



BARSOLETA E DITËS



Vajza: Mami, sot u përgjigja e para në mësim.
Mami: Të lumtë bija e mamit, po cila ishte pyetja?
Vajza: Kush ka ardhur pa përgatitur?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00
Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min


Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00
STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30
THE GRUDGE


Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI A keni qenë duke menduar për adoptimin e një kafshe? Nëse po, sot është dita ideale që të shkoni në qendër dhe të merrni një.</p>	 <p>DEMI Një person që doni mund t'ju japë frymëzim për një projekt krijues me të cilin po punoni.</p>	 <p>BINJAKËT Një ngjarje sociale që do ta mbani në shtëpinë tuaj mund t'ju frymëzojë që të bëni disa ndryshime në shtëpi.</p>	 <p>GAFORRJA Sot do t'ju vijë një mesazh i gjatë dhe i dashur nga një grua e cila ka gjasa të jetë nëna juaj.</p>	 <p>LUANI Sot mund t'ju vijë një shumë e vogël parash, ndoshta falë përpjekjeve të një gruaje.</p>	 <p>VIRGJËRSHA Energjitë e ditës së sotme do të sjellin sukses dhe të ardhura të mira.</p>
 <p>PESHORJA Sot do të keni shumë imagjinatë dhe do ta fusni në punë për të krijuar diçka të madhe, e cila do të shërbejë për t'i rritur interesat tuaja në biznes.</p>	 <p>AKREPI Mos u surprizoni nëse ndieni tërheqje të madhe për një person që e keni takuar në punë.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot do të kuptoni se keni një ndjenjë të fuqishme dashurie për dikë që jeton larg.</p>	 <p>BRICJAPI Dashuria dhe pasioni mund të jenë në mendjen tuaj.</p>	 <p>UJORI Nëse jeni beqarë, ju mund të takoni dikë që ju ka pëlqyer prej kohësh, por nuk ia keni shprehur.</p>	 <p>PESHQIT Sot do të keni shumë imagjinatë dhe do ta fusni në punë për të krijuar diçka të madhe, e cila do të shërbejë për t'i rritur interesat tuaja në biznes.</p>

Meghani, kostum të ngjashëm si të vjehrrës së vet Lady Di



Veshja e Meghan Markles në Ditën e Commonwealthit është e ngjashme me të vjehrrës së saj, Princeshës Diana. Një kostum të gjelbër sikurse Meghan, Lady Di e veshi në vitin 1982 kur ishte shtatzënë me Princin William. Në fakt, arsyeja e

vërtetë pse u bë shumë zhurmë në media është edhe pamja e Meghanit e jo drama që po ndodh në familjen mbretërore. Sigurisht se kjo nuk është hera e parë që Meghan është veshur si Diana. Ajo vesh shpesh veshje të frymëzuara nga veshjet më ikonike të Dianës.



Vajza e Jenniferit emocionohet nga takimi me Billie

Jennifer Lopezi dhe vajza e saj Emme u takuan me Billie Eilish. Artistja e famshme 50-vjeçare dhe vajza e saj 12-vjeçare bënë disa fotografi së bashku që i publikuan

në rrjete sociale. Disa fansa as nuk e kanë vërejtur që edhe Emme ishte në fotografi. Këtyre imazheve Jenn i vuri përshkrimin "Kur Emme takohet me Billie".

Edhe Celine Dion testohet për koronavirus



Celine Dion po rikuperohet. Këngëtarja 51-vjeçare është detyruar t'i shtyjë datat e ardhshme të turneut në Uashington dhe Pittsburgh pas

ftohjes që mori. Kur i filluan t'i shfaqeshin simptomat, mjekët për të qenë të sigurt i bënë edhe testin për koronavirus por, për fat të mirë, ajo rezultoi negative.

Harvey Weinstein dënohet me 23 vjet burgim



Ish-producenti i filmave Harvey Weinstein u dënua me 23 vjet burgim për sulm seksual. Weinstein u shpall fajtor në gjykimin që u mbajt në Nju Jork muajin e kaluar. 67-vjeçari u paraqit në

gjykatë të mërkurën në një karrocë. Avokatët e Weinstein kishin apeluar për zbutje dënimi duke këmbëngulur që edhe dënimi minimal prej pesë vjetësh mund të ishte një "dënim i përjetshëm" për të, raporton BBC.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Dajaku: Ferizajt po tregon karakter, duam pikë ndaj Prishtinës

Taulant Dajaku është optimist se skuadra e Ferizajt mund të marrë të paktën një pikë nga përballja me Prishtinën në stadiumin "Fadil Vokrri". "Është një moment i mirë në aspektin sportiv për ne si lojtarë pasi më duhet ta pranoj se ka pasur dhe ka ende shumë turbullira në aspektin financiar dhe nga një kaos si ky është vërtet vlerë e madhe e treguar në aspektin sportiv nga ana jonë si lojtarë dhe ky është një tregues se sa karakter dhe sa të fortë jemi bërë në momentin që kemi gjetur balancat e duhura brenda nesh si ekip", ka thënë Dajaku

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 11 MARS - Mesfushori Taulant Dajaku është i lumtur për rezultatet e skuadrës së Ferizajt në ndeshjet e fundit. Ky klub, që është në garën për mbijetesë në tri ndeshjet e fundit, ka marrë gjashtë pikë, pasi ka humbur nga Ballkani dhe ka fituar ndaj Llapit dhe Trepçës '89. Dajaku për "Epokën e re" ka thënë se rezultatet e Ferizajt janë shumë të rëndësishme duke pasur parasysh edhe vështirësitë financiare. "Është një moment i mirë në aspektin sportiv për ne si lojtarë pasi më duhet ta pranoj se ka pasur dhe ende ka shumë turbullira në aspektin financiar dhe nga një kaos si ky është vërtet vlerë e madhe e treguar në aspektin sportiv nga ana jonë si lojtarë dhe ky është një tregues se sa karakter dhe sa të fortë jemi bërë në momentin që kemi gjetur balancat e duhura brenda nesh si ekip", ka thënë Dajaku.

Mesfushori nga Drenica po luan rol kryesor në rezultatet e skuadrës së Ferizajt dhe në këtë klub po vlerësohet edhe si lider. Ai nuk dëshiron që meritat t'i ketë në adresë personale, por në kolektiv. "Nuk më pëlqen të më faturon meritat për këto suksese, pasi meritat është i gjithë grupi që kemi kontribuar për ta marrë maksimumin. Personalisht po ndihem mirë, se tash po mund ta jap kontributin tim për ekipin pasi që vjet jam penalizuar shumë dhe s'kam pasur hapësira për shkaqe të zgjedhjeve të çuditshme taktike dhe kam vuajtur shumë në atë periudhë", ka shtuar ai.

Klubi i Ferizajt ndeshjen e radhës e



zhvillon të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" ndaj Prishtinës. Në ndeshjen e fundit që është zhvilluar pak javë më parë, Ferizajt është mposhtur me rezultat 3-2. Lidhur me ndeshjen e radhës, Dajaku ka bërë me dije se synohet një rezultat pozitiv. "Ndeshja e radhës është shumë e vështirë pasi luajmë ndaj një ekipi të fortë dhe që i duhen pikët në luftën për titull, por

edhe neve na duhet një rezultat pozitiv që do të ishte një hap dhe më afër gjërave që po pretendojmë dhe shpresojmë ta kemi ditën tonë", ka thënë Dajaku, i cili mungon në këtë ndeshje për shkak të kartonëve. Aktualisht Ferizajt zë vendin e dhjetë me 25 pikë të grumbulluara, ku nga 21 ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar 8 fitore, 1 barazim dhe 13 humbje.

SHKURT

Kuka: Kosova duhet të ndërmarrë masa mbrojtëse nga koronavirusi

Federata Botërore dhe ajo Evropiane e Xhudos kanë suspenduar të gjitha aktivitetet deri në fillim të muajit maj për shkak të koronavirusit. Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka apeluar që Kosova duhet të ndërmarrë masa dhe çdo njeri që hyn në vend, të vetizohet për dy javë. "Minimumi që do të duhej që Kosova në këtë moment ta ndërmarrë është që çdo njeri që hyn në Kosovë të vetëkarantinohet për dy javë duke ndjekur udhëzimet e duhura si të sillet gjatë kësaj kohe. Kosova deri tash, për fat të mirë, s'ka ende raste, por pse të mos mbesim të tillë edhe më tutje. Shqipëria u mobilizua pas rasteve të shfaqura e ne të mobilizohemi para se të ndodhin", ka shkruar Kuka.

Anulohet miqësorja Kosovë - Shqipëri

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar opinionin se është anuluar grumbullimi dhe zhvillimi i ndeshjeve miqësore të Përfaqësueses U19 të Kosovës me Kombëtaren U19 të Shqipërisë. "Vendimi është marrë nga Komiteti i Emergjencës i Federatës Shqiptare të Futbollit - FShF, në mirëkuptim me Federatën e Futbollit të Kosovës dhe ka ardhur në vijim të konsultimeve të FShF-së me specialistët përkatës si pasojë e situatës së fundit të krijuar në Shqipëri", thuhet në njoftimin e FFK-së. Grumbullimi ka qenë i parashikuar të bëhet në Shqipëri më 24-31 mars, ndërsa ndeshjet ishin parashikuar të luheshin në datat 29-31 mars.

Ronesa Ymeri në seminarin e rëndësishëm të EHF-së

Federata e Hendbollit e Kosovës vazhdon t'i kushtojë rëndësi të madhe trajnimit dhe shkollimit të stafit të saj. Zyrtarja e FHK-së, Ronesa Ymeri, ishte pjesëmarrëse e seminarit (Workshop) të rëndësishëm të Federatës Evropiane të Hendbollit. Seminarin është mbajtur të martën dhe të mërkurën në Vjenë të Austrisë, ndërsa temë e tij ishte avancimi i hendbollit të femrave. Në seminar kanë ligjruar plot 17 ekspertë të EHF-së nga vende të ndryshme. Janë prezantuar praktika të suksesshme për avancimin e hendbollit të femrave, që është një tjetër top-prioritet i Federatës sonë. "Kemi marrë informata të rëndësishme që do të na ndihmojnë në punën e mëtejme në FHK. Janë diskutuar tema të rëndësishme edhe për hendbollin tonë", ka thënë Ronesa Ymeri, e cila është administratore e FHK-së për marrëdhënie ndërkombëtare.

Rahoveci ndahet me Ilievskin, rikthen Locin

RAHOVEC, 11 MARS - KB Rahoveci e ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Marjan Ilievski. Ndërsa në vend të tij është rikthyer Bujar Loci, i cili e ka drejtuar në këtë edicion Prishtinën. "Synonim një rrugëtim më të gjatë së bashku, por udhët tona

ndahen këtu. Jo pse ne kemi vendosur ta bëjmë një gjë të tillë, por se këtë e kërkoi vetë Ilievski. Përkundër se i plotësuam kërkesat dhe kushtet që i kërkoi, fati s'ishte me të në këtë aventurë, andaj edhe vendosi ta mbyllë këtu. Secili që në një-

farë forme apo tjetrën kontribuon për klubin tonë, mbetet pjesë e neve. Kësisoj, e falënderojmë për gjithë mundin e tij për të shënuar sukses", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci. "Bujar Loci është vendosur si pasuesi më i mirë i

tij. Loci për dy vjet, me kapacitete edhe më të vogla në kualitet, arriti që ta dërgonte skuadrën tonë dy herë në finale, me shpresën se e treta dhe e vërteta të bëhet realitet në këtë edicion", thuhet në njoftimin e Rahovecit.



Futbollisti serb që pranoi të luajë për Kosovën: Nuk më intereson politika

PRISHTINË, 11 MARS - Në një rrëfim të fundit për mediat serbe, futbollisti Ilija Iviç insistoi se atij nuk i intereson politika dhe se e ka pranuar ftesën e ekipit Përfaqësues U19 të Kosovës pasi që ndihet i vlerësuar për punën që e ka bërë në fushën e lojës. Vendimi i futbollistit serb

që luan që tri vjet në skuadrën e Flamurtarit, Ilija Iviçit, për ta përfaqësuar Kosovën ngjalli një debat të madh në mediumet serbe, të cilat e akuzuan atë për tradhti, përderisa nëna e tij u largua nga puna në Komunën e Graçanicës. "Ndihem normal, sikur në shtëpi", ka deklaruar

Iviç. "Sinqerisht, isha i lumtur sepse dikush e kishte vlerësuar punën time të madhe dhe përkushtimin tim. Ndihesha në mënyrë fenomenale. U ndjeva ashtu si ndihet një futbollist kur ftohet nga një ekip kombëtar", shtoi Iviç. I pyetur se si ndikuan raportimet e mediave serbe pas

pranimit të ftesës, Iviç ka thënë se i intereson vetëm për futboll. "Mua s'më intereson politika. Unë dua të luaj futboll në fushën e lojës dhe të bëj gjithçka në mënyrën më të mirë të mundshme. Sinqerisht nuk më intereson politika aspak", ka thënë Iviç.



Federata e Futbollit e Maqedonisë kërkon nga UEFA shtyrjen e ndeshjes ndaj Kosovës

SHKUP, 11 MARS - Federata e Futbollit e Maqedonisë së Veriut zyrtarisht i ka kërkuar UEFA-së shtyrjen e ndeshjes me Kosovën e cila ishte caktuar të luhej më 26 mars në stadiumin "Todor Proeski" në Shkup. Përveç problemit me tifozët, të cilët tashmë janë ndaluar për këtë ndeshje nga ana e Qeverisë së Maqedonisë, ata kanë potencuar edhe problemin me arritjen e futbollistëve të përfaqësueses së tyre në Maqedoni. Për shkak të masave të qeverisë maqedonase, disa nga futbollistët e tyre, të cilët do të vinin nga vendet me nivel të nartë të pranisë së koronavirusit, eventalisht do të detyroheshin të izoloheshin në karantinë për 14 ditë. "Njoftim për shkresë drejtuar UEFA-së për shtyrje të ndeshjes Maqedoni - Kosovë. Federata e Futbollit të Maqedonisë edhe zyrtarisht me shkresë në UEFA ka kërkuar të shtyhet ndeshja Maqedoni - Kosovë në kuadër të gjysmëfinaleve të balotazhit për kualifikim në Kampionatin Evropian, e caktuar të luhet më 26 mars 2020 në arenën nacionale 'Todor Proeski' në Shkup. Në letërën e drejtuar deri te Shtëpia e Futbollit Evropian, përveç problemit me tifozët (ndalesë për praninë e publikut nga ana e qeverisë së vendit), FFM potencon problemin me arritjen



e futbollistëve të ekipit përfaqësues në vendin tonë, gjegjësisht izolimin-karantinën eventuale të disa futbollistëve të caktuar që do të vinin nga vendet me nivel të lartë të pranisë së virusit COVID-19. Pikërisht shkak i këtyre shkaqeve të jashtëzakonshme, Federata e Futbollit të Maqedonisë është në komunikim të vazhdueshëm dhe intensiv me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin për Shëndet Publik dhe në tërësi përmbahemi me rekomandimet e tyre, masat për parandalim apo edhe ndalesat. Gjithashtu, pas konsultimeve me përfaqësues të Federatave të Futbollit të Gjeorgjisë dhe Bjellorusisë, kur dihet se njëra prej dy vendeve do të jetë vendas i duelit final të Ligës së Kombeve më 31 mars ku do të diskutohet kualifikimi në EURO

2020, informatat jozyrtare thonë se është e mundshme që përfaqësuesja që do të sigurojë kualifikim në finale, të përballet me masa të caktuara për kujdes dhe mbrojtje shëndetësore gjatë hyrjes në cilindo prej dy vendeve. Edhe në aspekt të kësaj problematike, FFM gjithashtu është në kontakt të vazhdueshëm me dy federatat e vendeve të lartpërmendura dhe UEFA-në. Në pajtueshmëri me rekomandimet e fundit dhe ndalesat nga Qeveria e Maqedonisë për preventiva ndaj virusit COVID-19, Komisioni për Futboll të Moshat solli vendim që të gjitha ndeshjet e kategorive të reja dhe ndeshjet e ligave të fëmijëve të FFM të pezullohen për dy javët e ardhshme", thuhet në shkresën e Federatës së Futbollit të Maqedonisë së Veriut dërguar UEFA-s.

Lakersat bien në shtëpi, triumfojnë Houstoni dhe Clippersat

HOUSTON, 10 MARS - Skuadra e Lakersave është mposhtur me rezultat të ngushtë 104-102 nga Brooklyn në fushën e saj. Lakersat dominuan në pjesën e parë të ndeshjes (LeBron dhe Davis 55 pikë së bashku), por në të dytën erdhi përmbysja e ekipit mysafir. Dinwiddie me 23 pikë dhe LaVert me 22 sollën përmbysjen e mysafirëve. Fitoi skuadra tjetër e Los Anxhelosit, ajo e Clippersave, që mposhti me lehtësi Golden Staten (131-107). Ndeshje që ishte një formalitet për miqtë, ku u dallua Leonardo me 23 pikë (Curry qëndroi



pushim). Ekipi i San Antonios, falë 24 pikëve të Aldridges, e mposhti Dallasin (119-109), sfidë ku Spursi përmbysi shifrat në periodën e fundit. Skuadra e Houstonit e mposhti me rezultat 117-111 Minnesotan, duke qëndruar mes ekipeve elitë në Perëndim. Më i miri për teksanët

ishite Hardeni me 37 pikë. Fitore në sekondat e fundit për Boston, që mundi 114-111 Indiana jashtë fushe (Sabonis 28 pikë e Oladipo 27), ndërsa Chicago triumfoi 108-103 ndaj Clevelandit (White 20 pikë).

REZULTATET

Indiana - Boston	111-114
Washington - New York	122-115
Chicago - Cleveland	108-103
Houston - Minnesota	117-111
Memphis - Orlando	115-120
San Antonio - Dallas	119-109
Portland - Phoenix	121-105
Golden State - Clippers	107-131
Lakers - Brooklyn	102-104

SHKURT

Edhe miqësorja Gjermani - Itali do të luhet pa tifozë

Frika nga coronavirusi po prek me shpejtësi të gjithë botën e futbollit. Federata Gjermane e Futbollit ka njoftuar se miqësorja kundër Italisë, e planifikuar për t'u zhvilluar më 31 mars në Nuremberg, do të luhet pa praninë e tifozëve. Në fakt, ishte një vendim i pritshëm me atë që po ndodh me shumë vende evropiane, nga Italia, Spanja e Franca, pa harruar edhe Shqipërinë, që kanë ndërprerë ose vendosur t'i luajë pa tifozë ndeshjet e futbollit si masa parandaluese për përhapjen e coronavirusit. Nëse situata nuk përmirësohet në javët në vazhdim, vihet në rrezik serioz edhe zhvillimi i Evropianit gjatë verës (do të luhet në 12 vende të ndryshme të Evropës) dhe nuk do të ishte çudi nëse do të shtyhej për një vit.

Bayerni planifikon rikthimin e Kroosit

Bayern Muncheni ka shtuar bisedimet për ta rikthyer në skuadër ish-mesfushorin e tyre, Toni Kroos. Skuadra gjermane është e prirë ta rikthejë në skuadër 30-vjeçarin dhe të njëjtën do të tentojë ta bëjë gjatë verës. Sipas 'Diariomadridista', Bayerni ka arritur përpjekjen e tyre për fituesin e Kupës së Botës në vitin 2014. Kroos iu bashkua Real Madridit nga Bayern Munichut në vitin 2014 dhe ka shijuar një aventurë të suksesshme me shumë tituj të fituar. Manchester Unitedi dhe PSG-ja gjithashtu thuhet të jenë të interesuara për nënshkrimin e Kroosit.

Anulohet ndeshja Sevilla - Roma

Roma ka njoftuar zyrtarisht se nuk do të luajë nesër (e enjte) kundër Sevilas në ndeshjen e parë për 1/8-tën e Ligës së Evropës për shkak të mungesës së autorizimit nga autoritetet lokale spanjolle. Ndeshja e Ligës së Evropës kishte qenë në dyshim pasi qeveria spanjolle anuloi të gjitha fluturimet drejt Italisë dhe anasjelltas. "Roma nuk do të udhëtojë në Spanjë për ndeshjen kundër Sevilas në Ligën e Evropës, pasi avioni nga Italia nuk ishte i autorizuar të zbarkonte në Spanjë. Më shumë detaje nga UEFA së shpejti", thuhet në njoftim.

NBA-ja studion mundësinë e ndeshjeve pa tifozë

Dyer të mbyllura, ndeshje vetëm në qytetet ku nuk ka të prekur nga Coronavirusi, apo edhe ndërprerje të sezonit. Janë të shumtë skenarët që NBA do të diskutojë në dy ditët e ardhshme. Sipas ESPN, drejtuesit më të lartë dhe pronarët e skuadrave do të vendosin se si do ta përballojnë emergjencën që edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka nisur të bëhet serioze me më shumë se 1 mijë të prekur dhe 30 të vdekur në 39 shtete. Komisionari i NBA-s, Adam Silver, ka parashikuar një sërë video-konferencash me pronarët e 30 skuadrave. Vendimet do të diskutohen me Shoqatën e Basketbollistëve. Ndeshjet pa tifozë nuk i pëlqen askush, pasi kjo masë do të shoqërohej me një faturë financiare, të llogaritur me një humbje nga 3.5 deri në 4 milionë dollarë për çdo sfidë. Ndërkohë vetë skuadrat kanë nisur të mbrohen, duke vendosur një sërë masash të brendshme. Kështu, dhomat e zhveshjes qëndrojnë të mbyllura, intervistat bëhen në një distancë jo më afër se 180 cm, nuk lejohen takimet me tifozët dhe dhënia e autografeve.



Njoftim

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" -Limak Kosovo, njofton të gjithë qytetarët të cilët kanë udhëtuar përmes këtij aeroporti se nëse kanë humbur valixhet e tyre dhe akoma kanë raportin nga zyra e 'Lost and Found' apo dokumente tjera që dëshmojnë një gjë të tillë, të lajmërohen në aeroport deri më datë **31 Mars 2020** për të vazhduar procedurat e identifikimit dhe tërheqjes së valixheve të tyre.

Valixhet të cilat kanë mbetur në aeroport më shumë se 6 muaj dhe nëse pronarët e tyre nuk lajmërohen deri në datë **31 Mars 2020**, atëherë këto valixhe do të jepen donacion Shoqatave Humanitare që ushtrojnë veprimtaritë e tyre në Kosovë.

Për cdo të dhënë shtesë ju lutem të kontaktoni zyren e 'Lost and Found' në aeroport në numër të telefonit: **00383 49911193**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 11.03.2020

Referenca: AAPSK - 04/2020

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillëstar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Kamion MAN viti i prodhimit 1967 dizel ngjyre e gjelbër, për pjesë	1 copë për pjesë	1,200.00€		
2	Rimorkio, ngjyre hiri- për pjesë	1 copë për pjesë	250.00€		
3	VW Golf II, ngjyrë e zeze, për skrap	1 copë për skrap	157.76€		
4	VW Golf III, ngjyrë e bardhe, për skrap	1 copë për skrap	183.60€		
5	VW Taureg, ngjyrë e hirit, për skrap	1 copë për skrap	150.00€		
6	Opel Astra, ngjyre e hirit metalike, për skrap	1 copë	204.80€		
7	Opel Kadet, ngjyre e hirit, për skrap	1 copë për skrap	150.45€		
8	VW Golf II, ngjyrë e kuqe, për skrap	1 copë për skrap	157.76€		
9	VW Golf I, ngjyrë e verdhë, për skrap	1 copë për skrap	164.05€		

Oferta e nënshkruar, vëlosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 18.03.2020 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes (në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 16.03.2020, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukur KK Prishtinë.

Pasurit e konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen sig janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-sc,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Marbleks" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurit dekorativ në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.04.2020 në ora 11:00 në objektet e kompanisë "Green Power" sh.p.k. në fshatin Zatriq komuna e Rahovecit do të organizohet debat publik nga kompania "Marbleks" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurit dekorativ në Rahovec.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Lumë's Details

Estetik & Depilim



Fatlume Shabani

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

Salloni i Depilimit 'Lumë's Details' në Prishtinë kërkon një praktikante e cila pastaj mund të punësohet me pagesë nëse tregon rezultat të mirë gjatë kohës së praktikës.

Të interesuarat mund të paraqiten në këta numra kontaktues: 045681898 dhe 044900978



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit

Ministarstvo Infrastrukture i Sredine - Ministry of Infrastructure and Environment

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore**

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 7114/19 të datës 06.12.2019, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
<http://mia-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit

Ministarstvo Infrastrukture i Sredine

Ministry of Infrastructure and Environment

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore**

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 6003/19 të datës 07.10.2019, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
<http://mia-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

**D.P.T "Vëllezërit Hoxha" Milaim
Likaj shpall të pavlefshme
certifikatën e biznesit me nr:
811015008 me seli në Runik.**

**D.P.T “Pesë vëllezërit” Mitrovicë
shpall te pavlefshem nb:
70132128 dhe nr: fis 600551891.**

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Shqiponja Ibra shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së meseme “Xhevdet Doda” Prishtinë.

► Fahredin Duraku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Bajram Curi " Krushë e Madhe.

► Skender Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Mustafa Baku " Prizren.

► Dibran Sope shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

► Dreni Dorambari shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Arton Regja shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren .

► Luan Elezkurtaj shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Ramiz Aliaj shpall të pavlefshme certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Rahim Rafshi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Arian Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jemin kryeziu shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Hamit Hoxha shpall të pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Sinan Nerjovaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit " Has. Nysret Gavazaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

► Granit Kabashi shpall të pavlefshme diplomën shmlt " 11 Marsi " Prizren

► Fllanza Bislimaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Naim Frasheri " Kobaje.

► Bujar Shala shpall të pavlefshme dëftesat e shm " 11 Marsi " Prizren.

► Agon Vehapi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Riza Likaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Sali Loshi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Flora Zekaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Elbasan Buduri shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Shaban Musliu, shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të -I- të shkollës së mesme teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

AUTOSHKOLLA RITMI

044 248 173
045 626 123
044 648 122

PRISHTINË

autoshkollaritmi@gmail.com



Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020

